




REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E BRENDSHME



Tetor 2017

2015-2020

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE PËR
DECENTRALIZIMIN DHE QEVERISJEN
VENDORE

Raporti i Dytë i Monitorimit



STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE

PËR DECENTRALIZIMIN

DHE QEVERISJEN VENDORE

2015-2020

Raporti i Dytë i Monitorimit

Tetor 2017

Ky raport u përgatit me asistencën e Programit për Decentralizim dhe Zhvillim Vendor (DLDP), zbatuar në Shqipëri nga Helvetas Swiss Intercooperation dhe financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet apo qëndrimet e DLDP apo Qeverisë Zvicerane.

TABELA E PËRMBAJTJES

SHKURTESAT	6
1 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
2 HYRJE	10
3 VLERËSIM I PËRGJITHSHËM MBI ECURINË E ZBATIMIT TË STRATEGJISË	11
4 ECURIA E ZBATIMIT TË STRATEGJISË SIPAS SECILIT QËLLIM STRATEGJIK	13
4.1 Progresi i arritur drejt: Rritjes së efikasitetit në tërësi të strukturave të qeverisjes vendore	13
4.1.1 Objektivi strategjik: Reforma administrative – territoriale	14
4.1.2 Objektivi strategjik: Strukturat e qeverisjes vendore.	15
4.2 Progresi i arritur në drejtim të forcimit të financave vendore dhe rritja e autonomisë fiskale	16
4.2.1 Objektivi strategjik: Reformimi i sistemit të të ardhurave vendore	17
4.2.2 Objektivi strategjik: Përmirësimi i menaxhimit financiar në nivelin vendor	19
4.3 Progresi i arritur në drejtim të nxitjes së zhvillimit të qëndrueshëm vendor	22
4.3.1 Objektivi Strategjik: Funkcionet e qeverisë vendore	24
4.4 Progresi i arritur në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë në nivel vendor dhe zbatimit të të drejtave të qytetarëve	28
4.4.1 Objektivi Strategjik: Zhvillimi i kapaciteteve të njësive të qeverisjes	28
4.4.2 Objektivi Strategjik: Sigurimi i një qeverisje të hapur, rritjes së transparencës, llogaridhënies dhe shtrirjes më të madhe të qeverisjes në nivelin vendor.	29
4.4.3 Objektivi Strategjik: Integrimi evropian dhe qeverisja vendore	31
5 SIDAT E REALIZIMIT TË STRATEGJISË	33
6 AKTIVITETET KRYESORE DERI NË FUND TË VITIT 2017	35
7 METODOLOGJIA E MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT	36
8 STATUSI I ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT 2015-2020 DERI NË TETOR 2017	38

Shkurtesat

AZRT	Agjencia e Zbatimit të Reformës Territoriale
BE	Bashkimi European
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DLDP	Decentralization and Local Development Programme / Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Vendor
E-PAV	Regjistri Elektronik për Administratën e Pushtetit Vendor
FZHR	Fondi për Zhvillimin e Rajoneve
KiE	Këshilli i Europës
ICT	Information Communitation Technology
IFTH	Sistemi i Informatik Financiar i Qeverisë (Sistemi i Thesarit)
IT	Information Technology
IOSSH	Integrated One Stop Shop (Zyra e Integruar me Një Ndalesë)
NjA	Njësi Administrative
NJQV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
MZHU	Ministria e Zhvillimit Urban
MBNJ	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
MB	Ministria e Brendshme
MEPJ	Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
MIAP	Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike
MCV	Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PLGP	Projekti i USAID për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor i Territorit
QQ	Qeverisja Qëndrore
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VNT	Vlerësimi i Nevojave të Trajnimit
RAT	Reforma Administrative Territoriale
SECO	Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike (Zvicër)
STAR	Projekti “ Support to Territorial Administrative Reform”
SHAP	Shkolla e Administratës Publike
SKNDQV	Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore

1 Përmbledhje ekzekutive

Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (SKNDQV) 2015-2020¹, e miratuar në muajin korrik 2015, mbylli ciklin e dytë të zbatimit në korrik 2017 dhe ka hyrë në vitin e tretë të zbatimit të saj. Ky raport monitorimi paraqet ecurinë e zbatimit të aktiviteteve të Planit të Veprimit të Strategjisë, në vitin e dytë të zbatimit, por raportimi i gjetjeve shtrihet deri në fund të muajit Tetor 2017.

Bazuar në metodologjinë e hartimit të raportit, fokusi i tij është i orientuar në dy drejtime:


(i) prezantimi i arritjeve dhe problematikave të ndeshura **gjatë vitit të dytë të zbatimit** të Strategjisë

(ii) **vlerësimi progresiv i zbatimit** të aktiviteteve të Planit të Veprimit 2015-2020

Një element i veçantë i këtij raporti krahasuar me raportin e vitit të parë të Strategjisë 2016, është raportimi i arritjes së treguesve të monitorimit të vlerësimit, të cilat prezantojnë arritjen e synimeve afatmesme të Strategjisë.

Ecuria e zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në strategji është në nivele të kënaqshme. Nga 91 aktivitete ose 61% të nisura në vitin e parë të zbatimit, ky nivel arriti në masën 85%, ose 123 aktivitete. Shkalla e realizimit të aktiviteteve në vitin e parë ishte në masën 30%, ndërsa në vitin e dytë të zbatimit të strategjisë arriti në total në masën 36% (ose 42% të aktiviteteve që kanë filluar të zbatohen).

Grafiku 1: Shkalla e zbatimit të Planit të Veprimit në %



Numri i Aktiviteteve

Të realizuara	52
Në zbatim	71
Nuk kanë nisur të zbatohen	19
Fillojnë pas 2017	3

Rezultatet kryesore të arritura në vitin e dytë të zbatimit të Strategjisë janë:

- Ngritja e *Këshillit Konsultativ* si instrumenti kryesor për koordinimin institucional dhe monitorimin e zbatimit të reformave të decentralizimit e vetë strategjisë;
- *Krijimi i Nënkomisionit "Për qeverisjen vendore"*, në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar "Për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut";
- Miratimi i *Ligjit nr. 68/2017, "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore"*, i cili adreson disa nga dobësitë strukturore të sistemit financiar ndërqeveritar dhe përmirëson kuadrin ligjor për menaxhimin e financave publike vendore. Në të njëjtën kohë, vijon puna për hartimin dhe rishikimin e akteve nënligjore për zbatimin e e këtij ligji;
- Miratimi i *Ligjit të Prefektëve*;

¹ Strategjia u hartua me mbështetjen e Projektit për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP), të financuar nga USAID

- Miratimi i Planeve të Përgjithshme Vendore për 26 Bashki;
- *Plotësimi i bazës ligjore të planifikimit dhe zhvillimit të territorit* me akte nënligjore dhe udhëzime të Ministrisë mbi zbatimin e PPV, konvertimin e tokës bujqësore, sistemin e lejeve dhe krijimin e hapësirës publike;
- *Plotësimi i kuadrit ligjor lidhur me funksionet e reja dhe plotësimi i kuadrit ligjor lidhur me shërbimet sociale;*
- *Rritja e transfertës së pakushtëzuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore nga buxheti i shtetit me 2.5 miliardë lekë (ose 19%) në krahasim me vitin 2016;*
- *Rritja e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore të mbledhura nga bashkitë me 28% dhe rritja e shpenzimeve për investime vendore me 2.9 herë në gjysmën e parë të vitit 2017 në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2016;*
- *Përmirësimi i treguesve makroekonomikë lidhur me planifikimin e të ardhurave për pushtetin vendor.* Pësha specifike e të ardhurave të planifikuara për pushtetin vendor kundrejt PBB në vitin 2017 u rrit me 0.1 pikë përqind në krahasim me buxhetin e vitit 2016;
- *Progresi në drejtim të rritjes së transparencës dhe hapjes ndaj publikut si në fushën e financave vendore dhe në drejtim të transparencës bashkiake;*
- *Krijimin e arkivës dhe librarisë elektronike të materialeve të trajnimit për qeverisjen vendore;*
- *Progresi i mëtejshëm është bërë lidhur me përdorimin e mjeteve të TIK për ofrimin e informacionit me publikun.*

Edhe pse u arrit progres në shumë aspekte ***ende nuk është arritur progresi i duhur lidhur me:***

- Ngritjen e kadastrës fiskale të pasurive të paluajtshme që do të ndihmojë në përmirësimin e administrimit fiskal në nivel vendor;
- Krijimin e sistemeve efektive të administrimit të të ardhurave të veta të qeverisjes vendore;
- Procesin e transferimit dhe inventarizimit të aseteve në nivelin vendor dhe reflektimin e tyre në pasqyrat financiare të qeverisë;
- Aplikimin e një sistemi të integruar të planifikimit të mirëmbajtjes së rrugëve në nivel vendor me synim rritjen e efikasitetit të investimeve në infrastrukturën rrugore;
- Zbatimin korrekt të ligjit për shërbimin civil në nivelin vendor.

Disa nga sfidat me të cilat vazhdon të përballë reforma e decentralizimit dhe ajo administrativo - territoriale janë:

- *Rritja e burimeve të financimit nga të ardhurat e veta të qeverisjes vendore, duke përfshirë këtu reformën e taksës mbi pasurinë e paluajtshme;*
- *Zbatimi i planeve të përgjithshme vendore të territorit, procesi i cili po has vështirësi lidhur me: (i) mungesën e burimeve financiare; (ii) mundësitë dhe kapacitetet e kufizuara të bashkive në grumbullimin e përpunimin e të dhënave mbi territorin dhe pronësitë; (iii) mungesa e sistemit të integruar të informacionit në bashki; (iv) kapaciteteve jo të mjaftueshme për vlerësimin e shërbimeve dhe realizimin e studimeve të mundshmërisë, si dhe (v) vështirësive për të rekrutuar personel të kualifikuar;*
- *Krijimin e mundësive për NJQV, që të përdorin huamarrjen si instrument të rëndësishëm ligjor për financimin e investimeve kapitale brenda kuadrit të politikave kombëtare të menaxhimit të borxhit publik;*
- *Forcimi më tej i bashkëpunimit ndërmjet ministrive dhe bashkive lidhur me zbatimin e funksioneve të transferuara rishtazi në fushat përkatëse, pasi ende ka shumë paqartësi në*

zbatimin e funksioneve dhe financimeve në fushën e arsimit, ujitjes dhe kullimit, zjarrfikjes dhe shpëtimit, pyjeve dhe kullotave dhe rrugëve rurale;

- *Menaxhimi më eficient i financave vendore*: forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve teknike dhe njerëzore të administratës vendore për planifikimin e burimeve njerëzore dhe hartimin, zbatimin dhe monitorimin e programit buxhetit afat-mesëm (PBA), sigurimin e menaxhimit financiar transparent dhe efektiv dhe mirë administrimin e të ardhurave vendore;
- *Forcimi i monitorimit të detyrimeve të prapambetura, sidomos të atyre të reja të krijuara rishtazi*;
- *Zbatimi efektiv i Ligjit të Shërbimit Civil*: Krijimi i një administrate vendore të depolitizuar, të paanshme dhe profesionalisht të aftë për të siguruar mirëqeverisjen vendore dhe ofrimin efektiv dhe cilësor të shërbimeve publike për qytetarët;
- *Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve teknike dhe njerëzore* për njësitë e reja organizative të krijuara në nivel Bashkie për zbatimin e funksioneve të transferuara pranë tyre;
- *Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe monitorimi i tyre nga qeveria dhe qytetarët bazuar mbi ofrimin kundrejt standardeve minimale kombëtare* që duhet të hartohen për të gjithë shërbimet dhe që do të jenë të detyruara për t'u respektuar nga gjithë Bashkitë;
- *Rritja e bashkëpunimit ndërmjet bashkive dhe komunitetit të biznesit*: ndërmarrja e projekteve të përbashkëta nëpërmjet iniciativave të financuara bazuar në partneritetin – publik-privat.

Së fundi, një nga sfidat që duhet të zgjidhet lidhur me monitorimin e vetë strategjisë është **ngritja e një sistemi institucional të monitorimit të Strategjisë**, i cili të sigurojë një monitorim sistematik dhe të bazuar mbi një sistem të dhënash efektiv dhe sistematik që mblidhen nga niveli qëndror dhe ai vendor. Një nga mangësitë e sistemit të sotëm të monitorimit të strategjisë është mungesa e të dhënave për shumë tregues që do të duhet të grumbullohen direkt nga Njësitë e Qeverisjes Vendore.

Ministria e Brendshme duhet të krijojë një strukturë të monitorimit të strategjisë me burimet njerëzore dhe kapacitetet e nevojshme teknike.

2 Hyrje

Vizioni i Qeverisë i prezantuar në Strategjinë Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020 është: *"Fuqizimi i qeverisjes vendore dhe i procesit të decentralizimit me qëllim që të sigurohet një efikasitet më i lartë i vetë qeverisë vendore dhe rritje e autonomisë financiare dhe funksionale"*. Ky vizion ndjek parimet dhe standartet e përcaktuara në Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore dhe parimet e Hapësirës Administrative Evropiane për qeverisjen vendore.

Për arritjen e këtij vizioni gjatë periudhës 2015-2020 strategjia ka përcaktuar edhe prioritetet kryesore të Qeverisë të cilat janë:

- (i) përfundimi i reformës administrative - territoriale;*
- (ii) përmirësimi i procesit të decentralizimit të financimit publik;*
- (iii) rritja e cilësisë dhe përmirësimi i shërbimeve publike të siguruara nga qeveria vendore, në bazë të standarteve evropiane, duke i'u përgjigjur të drejtave dhe nevojave të qytetarëve;*
- (iv) rritja e transparencës dhe përgjegjshmërisë së qeverisë vendore;*
- (v) rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve, në veçanti, e grave dhe sigurimi adekuat i interesave të tyre si dhe grupeve të tjera të interesit në procesin e vendimmarrjes së qeverisjes vendore.*

Zbatimi i strategjisë është parashikuar të kalojë në tre faza:

Faza e parë: afatshkurtër (2015-2016): përfshin disa veprime dhe masa të menjëhershme, të cilat është e mundur të arrihen në një afat të shkurtër. Fokusi kryesor i reformave në këtë fazë është vendosur në rishikimin e të gjithë kuadrit ligjor ekzistues.


Faza e dytë – afatmesme (2017 deri 2018)

Në këtë fazë do të trajtohen çështje të rëndësishme që lidhen me zbatimin e reformës së re administrative – territoriale dhe konsolidimin e njësisive të reja vendore dhe konsolidimin e kapaciteteve të tyre të qeverisjes.

Faza e tretë – afatgjatë (2019 deri 2020)

Politikat dhe veprimet në këtë fazë do të orientohen nga zbatimi i kuadrit ligjor dhe reformave të hartuara në fazat e mëparshme dhe rishikimit afatmesëm që do t'i bëhet strategjisë. Në këtë fazë veprimet do të kenë përmbushjen dhe verifikimin e qëllimit final të strategjisë për rritjen e efikasitetit në nivel vendor dhe fuqizimin e qeverisjes vendore.


Duke konsideruar reformën territoriale si një ndër prioritetet kryesore të kësaj strategjie, masat e parashikuara në strategji në këto 6 vjet parashikojnë një proces të fillimit të zbatimit të saj në vitet e para, duke shkuar drejt procesit të konsolidimit të plotë në vitet e fundit të zbatimit të saj.



3 Vlerësim i përgjithshëm mbi ecurinë e zbatimit të strategjisë

Plani i veprimit përfshin 144 aktivitete të konkretizuara në arritjen e rreth 248 treguesve të rezultatit (produkteve) që masin edhe realizimin e tyre. Plani i Veprimit parashikon që 96% e aktiviteteve të filloheshin deri në vitin 2017. Vetëm 4% e aktiviteteve parashikohet të nisim në vitet 2019 – 2020. Aktualisht ka pasur një ecuri më të mirë në drejtim të fillimit të zbatimit të aktiviteteve, duke marrë parasysh parashikimet e planit të veprimit. 123 nga 144 aktivitete tashmë kanë filluar të zbatohen ndërsa numri i aktiviteteve të realizuara është 52 aktivitete (për gjithë periudhën e strategjisë).

Grafiku 2: Shkalla e zbatimit të Planit të Veprimit në %



Numri i Aktiviteteve

Të realizuara 52


Në zbatim 70

Nuk kanë nisur të zbatohen 19

Fillojnë pas 2017 3


Në nivel prioritetesh, progresi më i mirë paraqitet në shtyllën e katërt, që lidhet me forcimin e qeverisjes së mirë, e cila ka edhe numrin më të madh të aktiviteteve që janë realizuar, kurse më mbrapa paraqitet shtylla e dytë, reformat në financat vendore me 10 aktivitete të realizuara në total, edhe pse është shtylla me numrin më të vogël të aktiviteteve të planifikuara.

Grafiku 3: Statusi i zbatimit të aktiviteteve – në numër aktivitete



Ndërsa si nivel total të realizimit të aktiviteteve më mirë situata paraqitet lidhur me qëllimin e tretë “Nxjtja e Zhvillimit të Qëndrueshëm Vendor” ku shkalla e realizimit të aktiviteteve është në masën 50% .


Grafiku 4 : Statusi i zbatimit të aktiviteteve sipas secilit prioritet në %



Duhet përmendur se në nivel total të aktiviteteve të parashikuara në fazën e hartimit të Strategjisë nga 144 aktivitetet e parashikuara, 141 e tyre duhet të filloheshin deri në vitin 2017, dhe 46 aktivitete duhet të realizoheshin brenda vitit 2017.

Rezultatet e monitorimit tregojnë se nga 141 kanë filluar të realizohen 122 aktivitete, kurse nga 46 të planifikuara janë zbatuar 52 aktivitete. Pra nëse bëjmë një vlerësim numri i aktiviteteve të zbatuara është 13% më i madh se ai i planifikuar të zbatoheshin. Por në nivelin e lartë të realizimit, në fakt, ndikojnë ato aktivitete të cilat janë realizuar më herët nga afati i parashikuar.

Grafiku 5: Frekuenca e fillimit dhe mbarimit të aktiviteteve në vitin 2017



Informacion i detajuar mbi arritjen e aktiviteteve jepet në Matricën e Planit të veprimit në fund të raportit.


4 Ecuria e zbatimit të strategjisë sipas secilit qëllim strategjik

Në vijim jepet një analizë më e detajuar e aktiviteteve sipas secilës nga shtyllat apo qëllimet strategjike të Strategjisë.

4.1 Progresi i arritur drejt: Rritjes së efikasitetit në tërësi të strukturave të qeverisjes vendore

Situata e zbatimit të aktiviteteve brenda këtij prioriteti paraqitet si vijon:

Grafiku 6: Statusi i zbatimit të aktiviteteve në total
(në %)



Numri i Aktiviteteve

Të realizuara	11
Në zbatim	15
Nuk kanë nisur të zbatohen	2
Total	28

Siç shihet nga grafikët e mësipërm, gati 39% e aktiviteteve të parashikuara në kuadër të këtij qëllimi strategjik janë realizuar tashmë. Vetëm 7 aktivitete nuk kanë filluar ende. Këto aktivitete vazhdojnë të jenë ato që lidhen me vlerësimin e detajuar të mundësive për kontraktimin ose ofrimin e shërbimeve të përzgjedhura përmes partneritetit publik-privat dhe krijimit të një sistemi të dixhitalizuar integral në nivel kombëtar dhe vendor për rregjistrat e pronave të transferuara tek qeveria vendore.

Tabela e mëposhtme paraqet progresin e bërë në arritjen e disa rezultateve të synuara në lidhje me një pjesë të aktiviteteve të parashikuara në strategji nën këtë shtyllë, deri në vitin 2017.

Tabela 1: Arritjet kryesore në nivel aktivitetesh

Aktivitetet	Nivel Treguesit		2017
	Vitet bazë 2014/2015	Treguesi i synuar	Treguesi i arritur
Ngritja dhe funksionimi i Agjencisë së Zbatimit të Reformës Territoriale	Asnjë punonjës i emëruar	100%	100%
Programi i mbështetjes infrastrukturore për 61 bashkitë e reja	Asnjë projekt	20	32
Aplikimi i shërbimeve të integruara administrative me teknologjinë ICT për 61 bashkitë dhe njësitë administrative.	Asnjë shërbim	10 shërbime	109 shërbime 11 OSSH të ngritura
Asistenca teknike për administratorët e qytetit dhe administratorët lokalë	0% e administratorëve janë trajnuar	50%	100%
Asistencë për përgatitjen e buxheteve të konsoliduara dhe paketave fiskale të 61 bashkive	0 % bashki të trajnuara	100%	100%
Asistencë për harmonizimin e Planeve të Zhvillimit të Territorit sipas ndarjes së re administrative		Asistenca për 15 bashki	44 bashki të asistuar
Programi i lidërshiptit për kryetarët e rinj të 61 bashkive	0% e kryetarëve të trajnuar	100%	100%
Krijimi i një "help-desk-" të përhershëm dhe dhënie e ndihmës së vazhdueshme të bashkive në procesin e riorganizimit.	Asnjë kërkesë nga 61 bashkitë e reja	100 % e kërkesave të adresuara pranë Help Desk	100 % e kërkesave të adresuara pranë Help Desk
Strukturave komunitare në nivel vendor	0%	25% e bashkive	31% e bashkive
Ngritja e Këshillit Konsultativ dhe bashkëpunimit me shoqatat vendore.		Këshilli Konsultativ i ngritur	Këshilli Konsultativ i ngritur

4.1.1 Objektivi strategjik: Reforma administrative – territoriale


Edhe gjatë kësaj periudhe ka vijuar procesi i konsolidimit administrativ i bashkive. Një nga synimet kryesore të kësaj periudhe ka qënë *zgjdhja e problemit të detyrimeve të prapambetura*, të cilat financiarisht mbarten në administratat e reja. Deri në Qershor 2017, niveli i detyrimeve të shlyera arriti në 12.2 miliardë lekë, ndërsa vlera e mbetur për t'u shlyer është 9.1 miliardë lekë, shumë e cila do të vazhdojë të shlyhet në periudhën në vazhdim.

Programi i mbështetjes infrastrukturore ka vijuar edhe këtë periudhë duke e çuar numrin e projekteve të financuara nga Fondi i Zhvillimit nga 20 projekte në 2016 në 32 projekte, kryesisht ndërhyrje në investime në rrugë, ura, rikonstrukcione të autostradave, sisteme të ujësjellës kanalizime, parqe publike dhe ndërhyrje të tjera.

Ecure mirë ka vazhduar në aplikimin e shërbimeve të integruara administrative nëpërmjet aplikimit të teknologjisë së informacionit. Nga 9 bashki që kishin pilotuar mënyrat e ofrimit të shërbimeve përmes teknologjisë së informacionit, ky numër ka arritur në 11 Bashki. (Shkodër, Lezhë, Durrës, Elbasan, Korçë, Vau i Dejës, Mat, Klos, Sarandë, Berat dhe Fier) dhe po vijon ngritja e sistemit në Bashkinë e Roskovecit dhe të Patosit. Nga lista e identifikuar fillimisht e shërbimeve unike të qeverisjes vendore me 67 shërbime, kjo listë ka arritur në 109 shërbime dixhitale.

Pas hartimit të 44 Planeve të Përgjithshme Vendore, disa prej të cilave janë ende në proces, bashkitë kanë kërkuar pajisjen me një udhëzim mbi procedurat e zbatimit të PPV-ve dhe

Grafiku 7 : Zyrat e Shërbimeve me Një Ndales



konvertimin e tokës bujqësore, si edhe **rishikimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit**². Rishikimi i rregullores u kërkua me qëllim thjeshtësimin e procedurave në planet e detajuara vendore dhe ndryshimet në planet e detajuara të zonave me rëndësi kombëtare. Për këtë u realizuan konsultat me bashkitë dhe u morën komentet e nevojshme.

Bashkitë kanë plane të ndryshme që i referohen fushave të ndryshme si financa, arsimi, bujqësia, zhvillimi urban, por ajo që vihet re është mungesa e konsistencës pasi jo të gjithë sektorët bashkiakë janë të mbuluar nga planet sektoriale. Kjo situatë ndryshon për bashki të vogla (si psh Devoll, Fushë-Arrëz, Laç dhe Vau i Dejës.)¹

Vëmëndje i është kushtuar ngritjes së kapaciteteve të bashkive për të siguruar lidhjen e PPV-ve me procesin e Programimit Buxhetor Afatmesëm. Bazuar në metodologjinë e hartuar nga Programi Dldp, janë mbajtur disa trajnime dhe do të mbahen në muajt në vazhdim për të trajnuar ekspertë të bashkive për sigurimin e kësaj ndërlidhje në praktikë. Ministria e Financave edhe gjatë kësaj periudhe ka organizuar një seri tryezash të rrumbullakëta me bashkitë .

4.1.2 Objektivi strategjik: Strukturat e qeverisjes vendore.

Një arritje e rëndësishme në drejtim të forcimit të bashkëpunimit dhe koordinimit mes pushtetit qëndror dhe pushtetit vendor gjatë kësaj periudhe është ngritja e Këshillit Konsultativ. Këshilli i Ministrave vendosi më 21 dhjetor 2016 për themelimin e Këshillit Konsultativ (KK)³. KK nisi zyrtarisht funksionimin në janar 2017. Ai do të shërbejë si një platformë e institucionalizuar për konsultim midis qeverisë qendrore me autoritetet lokale dhe rajonale. Deri në fund të muajit Tetor, KK realizoi tre takime. Takimi i fundit i mbajtur më 1 nëntor, 2017 u fokusua tek diskutimi i buxhetit dhe paketës fiskale për vitin 2018.


Në drejtim të Programit të Transparencës dhe Pjesëmarrjes në vendimmarrjen në nivel vendor u realizua nga Projekti STAR2 vlerësimi kombëtar i transparencës dhe llogaridhënies në qeverisjen vendore, i cili u bë publik në konferencën e zhvilluar në 11 Tetor, 2017⁴. Vlerësimi konfirmoi se në përgjithësi, *reforma administrative – territoriale është bërë në dukje pjesë përbërëse e komuniteteve shqiptare në përgjithësi dhe e politikëbërësve në veçanti.* Gjetjet e vlerësimit të qeverisjes vendore tregojnë gjerësisht se edhe pse **sistemet e planifikimit dhe të ofrimit të shërbimeve kanë nisur të rrënjosen në bashki, cilësia e disa shërbimeve publike nuk ka arritur ende nivelet e parashikuara, transmetimi i informacionit te qytetarët vlerësohet si mesatar dhe ndërsa përballjet personale me korrupsionin janë të pakta, sistemet e gjurmimit të transparencës dhe performancës gjykohen të jenë të papërshtatshme. Një çështje me interes tejet të madh është niveli i ulët i angazhimit të qytetarëve në proceset demokratike.**

² E miratuar me VKM Nr 408 dhe më pas Nr 671/2015

³ Në përbërje të Këshillit Konsultativ përfshihen 9 anëtarë nga institucionet e qeverisë qendrore dhe 9 të tjerë që përfaqësojnë tre shoqatat e njësisive të qeverisjes vendore. Agjencia për Zbatimin e Reformës Territoriale do të luajë rolin e Sekretariatit Teknik për Këshillin.

⁴ *Perceptimi i Qeverisjes në një Shqipëri në Reformim* Vlerësimi Mbarëkombëtar i Situatës së Qeverisjes Vendore në Shqipëri , IDRA M.Chatterjee, UNDP në Shqipëri,

Grafiku 8 Vlerësimi i përgjithshëm i Qeverisjes Vendore




Burimi : Vlerësimi Mbarëkombëtar i Situatës së Qeverisjes Vendore në Shqipëri , (STAR 2)

4.2 **Progresi i arritur në drejtim të forcimit të financave vendore dhe rritja e autonomisë fiskale**

Grafiku 9 paraqet situatën e zbatimit të aktiviteteve në kuadër të këtij qëllimi strategjik dhe shkallën e realizimit të tyre. Siç shihet, vetëm 3 aktivitete nuk kanë filluar ende, ndërkohë që afro gjysma e aktiviteteve janë realizuar.

Grafiku 9: Shkalla e zbatimit të aktiviteteve (%)



Numri i Aktiviteteve

Të realizuara	17
Në zbatim	27
Nuk kanë nisur të zbatohen	9
Fillojnë pas 2017	3

Të vetmet aktivitete ku ende nuk po shihet progres i dukshëm lidhen me përdorimin nga ana e bashkive të instrumentit të huamarrjes, kjo pasi ende problem mbetet niveli i lartë i borxhit publik, shlyerja e detyrimeve të prapambetura dhe përmirësimi i situatës financiare të bashkive.

Tabela 2: Arritjet kryesore në nivel aktivitetesh

Aktivitetet	Nivel Treguesit		
	Vitet bazë 2014/2015	Treguesi Synuar	Treguesi Arritur
Hartimi i ligjit “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”	Nuk ka ligj të miratuar	Ligji i miratuar	Ligj nr. 68/2017
Rritja e normës së taksës së automjeteve në ndarje mes qeverisë qendrore dhe NJQV-ve	% e taksës së ndarë	30%	25%
Zbatimi i sistemit të ri taksës së pasurisë	Të ardhurat nga taksa e pasurisë, 0.16% e PBB-së	0.25% e PBB-së	0.31% e PBB
Mbështetje për administratën tatimore vendore për taksën e pasurisë dhe taksat vendore	5 bashki të asistuar	24 bashki kanë marrë asistencë teknike	8 bashki
Krijimi i një formule të re për transfertat e pakushtëzuar bazuar në kriteret më transparente, më të thjeshta dhe më objektive	Ndarja e transfertës me formulën e re	100 % e transfertës së pakushtëzuar ndahet me formulën e re	100 % e transfertës së pakushtëzuar ndahet me formulën e re
Përcaktimi i nivelit të transfertave për qeverisjen vendore si përqindje e totalit të të ardhurave publike	Transfertat nuk përcaktohen si % e totalit të të ardhurave publike	Transfertat përcaktohen si % ndaj totalit të të ardhurave publike	Transferta e pakushtëzuar do të jetë në nivelin e 1% të PBB-së
Identifikimi i borxheve të fshehura dhe hartimi i planeve specifike për mbulimin e borxheve	Asnjë bashki	100%	100%
Trajnimi i punonjësve të bashkive në fushën e menaxhimit financiar, auditit dhe prokurimit publik	0% e stafeve të bashkive të trajnuara	30%	100%
Bashkitë përdorin buxhetimin me sistemin PZHS dhe PBA (SDP e MTBP)	10% e bashkive	50% e bashkive	100% ⁵

4.2.1 Objektivi strategjik: Reformimi i sistemit të të ardhurave vendore

Arritja më e rëndësishme në fushën e financave vendore për këtë periudhë raportimi ka qënë Miratimi i projektligjit “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”⁶. Ligji është miratuar më 27 prill 2017. Ligji synon të forcojë autonominë financiare vendore, duke rritur nivelin, stabilitetin dhe parashikueshmërinë e transfertave ndërqeveritare, përfshirë këtu taksat e ndara, qartësimin e kompetencave fiskale të bashkive, dhe forcimin e rregullave për menaxhimin e financave publike, rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë në menaxhimin financiar vendor.

Analiza e realizimit të të ardhurave e shpenzimeve të qeverisjes vendore në vitin 2016, një vit pas zbatimit të reformës administrative – territoriale tregon disa të dhëna interesante mbi efektin e reformës administrative – territoriale.

⁵ 100 e bashkive hartojne dokumentin e PBA-se

⁶ Hartuar me ndihmën e projekteve PLGP/USAID dhe DLDP nën drejtimin e Ministrisë së Financave.

Kutia 1: Risitë e Ligjit të ri të Financave Vendore

- *Rritja e madhësisë së transfertës së pakushtëzuar për vitin 2018 dhe në vijim me mbi 30% në krahasim me mesataren historike prej rreth 12.5-13 miliard lekë të dhjetë viteve të fundit;*
- *Lidhja e madhësisë së transfertës së pakushtëzuar me një variabël makroekonomike, dhe më specifikisht jo më pak se 1% e Produktit të Brendshëm Bruto, dhe jo më pak se transfertat e ndarë një vit më parë;*
- *Rritja e parashikueshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së transfertave ndërqeveritare;*
- *Ndarja për herë të parë e 2% e të ardhurave nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale me bashkitë dhe rritja e normës së ndarjes së të ardhurave nga taksa e automjeteve për bashkitë nga 18% në 25%;*
- *Forcimi dhe harmonizimi i rregullave për procesin buxhetor dhe disiplinën fiskale e financiare në menaxhimin e financave vendore, si dhe forcimi i rolit më të madh mbikqyrës dhe koordinues të Ministrisë së Financave në këtë drejtim;*
- *Rritja e aftësisë së parashikueshmërisë së burimeve financiare publike në nivel vendor;*
- *Sigurimi dhe konsolidimi i një dialogu efektiv ndërmjet dy niveleve të qeverisjes për ndarjen e detyrave dhe burimeve;*
- *Unifikimi dhe standartizimi i procedurave të buxhetit vendor me qeverisjen qendrore;*
- *Përcaktimi i rregullave për menaxhimin e situatave të vështirësive financiare;*
- *Sigurimi dhe konsolidimi i një dialogu efektiv ndërmjet dy niveleve të qeverisjes për ndarjen e detyrave dhe burimeve;*
- *Rregullimi i procedurave për menaxhimin e situatave të bllokimit të miratimit të buxheteve nga këshillat e vetëqeverisjes vendore.*

Reformat e ndërmarra tregojnë një rritje të autonomisë fiskale dhe financiare të bashkive, por performanca e bashkive varion ndjeshëm. Bashkitë kanë të drejtë të kontrollojnë 75% të burimeve të financimit, ndërkohë që qeveria qendrore kontrollon 25% të totalit të fondeve që shpenzohen në nivel vendor nëpërmjet transfertave të kushtëzuara. Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat përbëjnë mesatarisht 35% të totalit të burimeve të financimit, megjithatë një vështirësi më e thelluar për 61 bashkitë individualisht tregon se ky raport varion nga 3% në 68%, duke evidentuar diferenca të theksuara në kufizimet e kapacitetit fiskal, autonomisë financiare dhe varësisë nga qeverisja. Transferta e pakushtëzuar nga buxheti i shtetit e cila mund të përdoret lirisht nga bashkitë mbetet burimi kryesor i financimit, duke përbërë mesatarisht mbi 50% të të ardhurave për 70% të bashkive të reja. Rritja e madhësisë së transfertave të kushtëzuara përkundrazi burimeve mbi të cilat bashkitë ushtrojnë kontroll, tregon për një interes në rritje të qeverisjes qendrore për të influencuar apo drejtuar zhvillimet në nivel vendor.⁷ Në fund të vitit 2016, të ardhurat e mbledhura nga bashkitë nga taksat dhe tarifatat vendore ishin 28% më të larta se në vitin 2015.⁸ Ndërkohë, gjatë periudhës Janar-Qershor 2017, këto të ardhura janë rritur sërish me rreth 28% në krahasim me periudhën Janar-Qershor 2016⁹.

⁷ Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, Status Raport Mbi Financat e Vetëqeverisjes Vendore 2016 – Nga vijnë dhe si përdoren fondet publike nga bashkitë e reja, fq 3 <http://www.financatvendore.al/pub/raporte>

⁸ USAID, PLGP, Raporti Statistikor: Financat Vendore në Shqipëri pas Reformës Administrative dhe Territoriale dhe në Prag të Zbatimit të Ligjit mbi Financat e Vetëqeverisjes Vendore, Qershor 2017, www.plgp.al, dhe Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, Status Raporti mbi financat e vetëqeverisjes vendore në vitin 2016, www.financatvendore.al;

⁹ Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, Raport mbi financat publike vendore, Tremujori II, 2017; www.financatvendore.al;

4.2.2 Objektivi strategjik: Përmirësimi i menaxhimit financiar në nivelin vendor

Rritja e të ardhurave nga administrimi më i mirë fiskal i taksave dhe tarifave vendore, reduktimi i kostove administrative të personelit, rritja e investimeve publike vendore dhe zbutja e diferencave dhe pabarazive ndërmjet bashkive ish-in ndërr pritshmëritë kryesore të reformës administrative dhe territoriale. Të dhënat e mëposhtme paraqesin rezultat në nivel kombëtar bazuar në vlerësimin e financave vendore në vitin e parë pas zbatimit të reformës.

Kutia 2: Financat vendore në fund të vitit të parë të zbatimit të reformës administrative territoriale – Fakte dhe Shifra viti 2016

*Të ardhurat nga taksat dhe tarifave vendore janë rritur me rreth 3.7 miliard lekë ose 28%; Kontribuesit kryesorë të rritjes së të ardhurave vendore janë taksat mbi pasurinë e paluajtshme (+19%), tarifave të shërbimeve të largimit të mbetjeve, ndriçimit publik dhe gjelbërimit (+58%), tarifave administrative (+27%) dhe taksat e ndikimit në infrastrukturë (+94%). Ndryshimet në kuadrin ligjor për taksën e zënies së hapësirës publike, të tabelave dhe fjetjes në hotel kanë sjellë një rritje të të ardhurave vendore me rreth 500 milionë lekë në vitin 2016. Ndryshimet dhe zvogëlimi i kompetencave të bashkive mbi tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël i ka kushtuar bashkive rreth tre herë më shumë, duke **humbur 1.5 miliard lekë në vitin 2016**. Të ardhurat nga taksat e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja, edhe pse në rritje të ndjeshme, vazhdojnë të ndikohen nga moratoriumi i lejeve për ndërtime të reja, ndryshimet në legjislacionin për planifikimin e territorit dhe ecuria e aktivitetit ekonomik në përgjithësi.*

Investimet publike të financuara nga vetë bashkitë janë rritur me 26% ose 2.2 miliard lekë në krahasim me vitin 2015. Ekzistojnë diferenca të thella në performancën individuale të bashkive në drejtim të investimeve: në 18 nga 61 bashkitë e reja, shpenzimet për investime kanë rënë nga -2 deri në -60% në terma vjetorë ndërkohë që në 18 bashki të tjera ato janë rritur me më shumë se 100% në krahasim me vitin 2015.

Rritje e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore është përkthyer në një rritje të investimeve publike me 2.2 miliard lekë. Nuk evidentohet një ulje e përgjithshme e shpenzimeve për pagat e personelit dhe atyre operative, sikurse pritej nga reduktimi i numrit të NjQV duke treguar se do të duhet kohë për shfaqjen e kursimeve dhe ekonomive të shkallës të pritura nga konsolidimi territorial. Megjithatë, duhet mbajtur në konsideratë se ekzistojnë diferenca të theksuara në performancën e bashkive në normën e rritjes së investimeve dhe uljes së kostove administrative.


Nga ana e funksioneve, në 2016, bashkitë kanë dedikuar mesatarisht 26% të buxheteve për administratën, 21% për infrastrukturën publike, 21% për shërbimet publike të pastrimit dhe largimit të mbetjeve, ndriçimit publik, gjelbërimit etj.; 20% për kopshtet, çerdhet dhe arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm; 8% për sportin, kulturën dhe qendrat sociale për njerëzit në nevojë; dhe së fundmi vetëm 1% për furnizimin me ujë.

Burimi: Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, www.financatvendore.al

Treguesit makroekonomikë kanë pësuar përmirësime të ndjeshme lidhur me planifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për pushtetin vendor. Siç shihet nga grafiku më poshtë pesha specifike e të ardhurave të planifikuara për pushtetin vendor kundrejt PBB në vitin 2017 u rrit me 0.1 pikë përqind në krahasim me buxhetin e vitit 2016 dhe një rritje prej 0.23 pikë përqind krahasuar më vitin 2013. Ndërsa niveli i shpenzimeve për qeverisjen vendore kundrejt PBB në vitin 2017 pësoi një ulje krahasuar me vitin 2016¹⁰ në masën 0.2%, por në vitin 2018 parashikohet të rritet me 0.03 pikë përqind. Kurse krahasuar me vitin 2013 shpenzimet buxhetore janë rritur më 0.4 pikë përqind në vitin 2017.

¹⁰ Kjo ulje vjen pasi deri në vitin 2017 fondet e Zhvillimit të Rajoneve janë konsideruar pjesë e shpenzimeve të pushtetit vendor. Në vitin 2017, u xheti i FZHR, u bë pjesë e buxhetit të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe nuk raportohet të shpenzimet e vendorit.

Grafiku 10: Pesha specifike e të ardhurave dhe shpenzimeve të Pushtetit Vendor në % kundrejt PBB



Burimi: Ministria e Ekonomise dhe Financave¹¹

Edhe në këtë periudhë raportuese nuk ka progres në drejtim të rritjes së kapaciteteve të NJQV, që të përdorin huamarrjen dhe borxhin për financimin e investimeve kapitale brenda politikave kombëtare të borxhit publik¹². Likujtimi i detyrimeve të prapambetura është edhe një parakusht për fillimin e shëndoshjes financiare të bashkive. Niveli i borxhit deri në fund të vitit 2015 vlerësohej të ishte 9,7 miliardë lekë. Ky nivel në Qershor të vitit 2017 ka një ulje modeste, duke arritur nivelin 9.5 miliardë lekë.¹³ Duhet përmendur se ndërkohë që janë likjuar një sërë detyrimesh, duke arritur shifrën prej 12.2 miliardë lekë, ky nivel ende nuk ka arritur të ulet si rezultat i detyrimeve të krijuara rishtazi, ku një vlerë të konsiderueshme zënë detyrimet e krijuara rishtazi nga Bashkia e Tiranës në vlerën 3.7 miliardë lekë.

Hapa të rëndësishme ligjore janë ndërmarrë në drejtim të konsolidimit të sistemit të buxhetimit dhe menaxhimit financiar në nivelin vendor. Ndryshimet më të fundit të Ligjit Organik të Buxhetit, realizuar me Ligjin nr. 57/2016 përfshijnë në mënyrë të zgjeruar e detajuar rregullat e reja të menaxhimit të sistemit të buxhetit në nivelin vendor. Ligji i ri përcakton qartë rregullat dhe procedurat e hartimit dhe miratimit të buxhetit vendor dhe programin buxhetor afatmesëm. Një nga risitë e rëndësishme të ligjit është detyrimi ligjor i vendosur që përcakton organizimin nga Ministria e Financave e takimeve me njësitë e qeverisjes vendore për programin buxhetor afatmesëm. Është bërë përmirësim në lidhje me përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për njësitë vendore: (i) është rishikuar Instrumenti i Planifikimit Financiar (IPF)¹⁴ dhe (ii) për herë të parë në portalin e financave të qeverisjes vendore janë botuar "PBA-të 2018 - 2020" të NjQV, edhe pse jo të gjitha bashkitë e kanë publikuar dokumentin e PBA-së në faqen e tyre të internetit.


¹¹¹¹ Të dhënat sipas prezantimit të projekt buxhetit 2018 nga MEF në takimin e Këshillit Konsultativ në 1 Nëntor, 2017

¹² Objektivi Specifik II.3

¹³ MEF Raporti 6 muajor i Detyrimeve të Prapambetura të Qeverisjes Vendore Dhjetor 2016 dhe Qershor 2017

¹⁴ IPF u shërben njësitë të qeverisjes vendore si një udhëzues për përgatitjen e PBA-së. Zbatimi i tij ka filluar gjatë gjysmës së dytë të vitit 2017, në të gjitha bashkitë.

Grafiku 11 Bashkitë që kanë publikuar buxhetet lokale për vitin 2017



Belsh	Berat	Bulqizë	Cërrik	Delvinë	Devoll
Dibër	Divjakë	Dropull	Durrës	Elbasan	Fier
Finiq	Gjirokastrë	Gramsh	Has	Himarë	Kamëz
Kavajë	Këlcyrë	Klos	Kolonjë	Konispol	Korçë
Krujë	Kuçovë	Kukës	Kurbini	Lezhë	Libohovë
Librazhd	Lushnjë	Malësi e Madhe	Maliq	Mallakastër	Mat
Memaliaj	Mirditë	Patos	Peqin	Përmet	Pogradec
Poliçan	Prrenjas	Pukë	Pustec	Roskovec	Rrogozhinë
Sarandë	Selenicë	Shijak	Shkodër	Skrapar	Mallakastër
Tepelenë	Tiranë	Tropojë	Ura Vajgurore	Vlorë	Vau i Dejës
Fushë-Arrëz					

Burimi: MoF website

Ka pasur ecuri të mirë në drejtim të ngritjes së kapaciteteve për forcimin e sistemit të administrimit të financave publike në nivel vendor. Është hartuar Manuali mbi Planifikimin Financiar dhe është ngritur *help desk* pranë MF, për t'u ardhur në ndihmë gjithë bashkive. Janë finalizuar kurrikulat e trajnimit për Planin Strategjik të Zhvillimit (PSZH) dhe PBA, Buxhetin Vjetor dhe Zbatimin dhe Monitorimin e Buxhetit. Të gjitha bashkitë janë trajnuar për procesin e buxhetimit nëpërmjet SHAP (Shkolla Shqiptare e Administrates Publike). Një theks i veçantë i është vënë lidhjes së strategjive territoriale me Programet buxhetore afatmesme, në fazën e hartimit të tyre, për t'i bërë këto strategji sa më të qëndrueshme financiarisht. Janë asistuar 24 bashki në hartimin e Paketës Fiskale 2017, hartimin e buxhetit vjetor 2017 dhe hartimin e PBA 2018-2020, të lidhura këto edhe me strategjitë territoriale që po hartohen në kuadër të hartimit të PPV.

Është përmirësuar transparenca e financave publike për njësitë e qeverisjes vendore. Ministria e Financave ka përditësuar portalin <http://www.financatvendore.al/buxhetet> e financave të qeverisë lokale. Nga 36 bashki që kishin publikuar buxhetet e tyre në vitin 2016, ky numër në vitin 2017 arriti në 37 bashki përveç publikimit të të dhënave financiare dhe fiskale të njësive të qeverisjes vendore dhe analizës së tyre krahasuese, në portal është publikuar për herë të parë "PBA i Njësive të Qeverisjes Vendore 2018 - 2020" për 26 bashki. MF publikon gjithashtu Raportet mujore të të ardhurave, Raportet Mujore të Shpenzimeve, të Ardhurat për Frymë, Shpenzimet për Frymë, Buxheti Vjetor, Programi Buxhetor Afatmesëm, Paketa Fiskale, Korniza Legjislative që rregullon NJQV. Në gjashtë bashki: Korçë, Fier, Elbasan, Lushnjë, Berat dhe Kuçovë është realizuar një **platformë on-line për transparencën mbi shpenzimet dhe buxhetet** e njësive të qeverisjes vendore, ndërkohe që bashkia e Fierit dhe Kuçovës kanë hartuar edhe Udhëzuesin e Qytetarit mbi Buxhetin Vendor.

Është realizuar vlerësimi i parë i sistemeve të MFP në Shqipëri në nivel vendor bazuar në metodologjinë e PEFA. Qëllimi i vlerësimit ishte për të kuptuar më mirë pikat e forta dhe të dobëta të sistemeve të MFP-së në nivelin vendor. Vlerësimi ka evidentuar se dobësitë e MFP në nivel vendor në krahasim me nivelin qëndror lidhen me transparencën dhe mbikqyrjen e buxhetit, të cilat mbeten të rëndësishme në të gjitha elementet që lidhen me ciklin e buxhetit¹⁵. Gjetjet e vlerësimit u prezantuan në seminarin që u mbajt në 29 mars 2017 në Tiranë. Për të adresuar të gjitha dobësitë e identifikuar nga vlerësimi i sipërpërmendur, ekspertët nga SECO dhe USAID-i

¹⁵ Vlerësimi i PEFA u realizua gjatë gjysmës së dytë të vitit 2016, në 5 bashki Tirana, Berati, Fieri, Kuçova dhe Tropoja, dhe pati si fokus (a) Besueshmërinë e buxhetit; (b) Gjithëpërfshirja dhe transparenca; (c) Menaxhimi i Pasurive dhe Pasiveve; (d) Strategjia fiskale e bazuar në politika dhe buxhetimi; (e) Parashikueshmëria dhe kontrolli në ekzekutimin e buxhetit (f) Kontabiliteti dhe raportimi; dhe (g) Shqyrtimi dhe Auditimi i Jashtëm.

kanë përgatitur plane veprimi për secilën prej 5 bashkive për forcimin e MFP-së në NJQV dhe ka filluar zbatimin e tyre.

Janë marrë hapa drejt përmirësimit të sistemit të monitorimit dhe raportimit të ekzekutimit të buxhetit vjetor të qeverisë për njësitë e qeverisjes vendore. Gjatë vitit 2016 në MF u krijua një departament i ri për t'u marrë me çështjet e qeverisjes vendore brenda Departamentit të Buxhetit. Drejtoria e Financave Vendore po përgatit formatet përfundimtare dhe aktet ligjore për përmirësimin dhe konsolidimin e formave të raportimit të buxhetit vendor. Raportet tremujore të monitorimit të buxhetit për qeverisjen vendore përgatiten dhe publikohen në faqen e internetit të MF-së.

Në kuadër të pastrimit të borxheve të fshehura dhe parandalimit të borxheve të reja MF ka përgatitur në bashkëpunim me NJQV-të, planin e veprimit për pagesën e vonesave¹⁶, si dhe ka forcuar masat ligjore dhe monitoruese me qëllim parandalimin e krijimit të borxheve të reja. MF përgatit raportin e monitorimit të vonesave të qeverisë vendore çdo tre muaj. Raporti i monitorimit për tremujorin e parë të vitit 2017 është publikuar në faqen e internetit të MF-së.

Ende nuk ka progres në zbatimin e Sistemit të kompjuterizuar të Informacionit Financiar të Trezarit në nivel vendor dhe procesin e regjistrimit të inventarit të plotë të pasurive publike, duke përfshirë vlerat dhe rregullat e amortizimit sipas standarteve kombëtare¹⁷. Nga 61 bashki, sistemi i IFTH funksionon vetëm në Bashkinë e Tiranës. Pavarësisht sistemit të IFTH, në vitin 2016 pritet që për herë të parë bilanci i NJQV të jetë pjesë e Pasqyrave Financiare të Qeverisë, duke siguruar në këtë mënyrë pasqyrimin e saktë të vendorëve të financave në qeverisjen e sistemit. Pas reformës territoriale, bashkitë kanë bashkëpunuar me zyrat Rajonale të Thesarit për të migruar (në pikëpamje të kontabilitetit) të dhënat e bilancit (në AGFIS) të njëjtit të qeverisjes vendore (bashkitë dhe komunat e mëparshme) në pasqyrat e tyre financiare. Procesi do të fillojë në bazat pilot me Bashkinë e Tiranës, dhe parashikohet të zgjasë deri në vitin 2020, duke hedhur të dhënat online nëpërmjet sistemit AGFIS.

4.3 Progresi i arritur në drejtim të nxitjes së zhvillimit të qëndrueshëm vendor


Strategjia përcakton rishikimin e funksioneve të qeverisjes vendore pas reformës administrative – territoriale si një nga prioritetet kryesore, me qëllim ripërcaktimin e përgjegjësisë së autoriteteve vendore mbi funksionet e veta dhe të përbashkëta, të cilat tashmë janë miratuar nga ligji i ri organik i qeverisjes vendore.

Siç paraqitet në grafikun e mëposhtëm, rreth 31% e aktivitetëve të parashikuara nën këtë qëllim prioritar, janë realizuar.

¹⁶ Në udhëzimin nr. 8, datë 13.01.2017, "Për zbatimin e buxhetit 2017" përfshihen udhëzime shtesë për të parandaluar krijimin e borxheve të reja për NJQV. Sipas udhëzimit NJQV janë të detyruara të raportojnë dhe dorëzojnë në Ministrinë e Financave informacione për pagesat e prapambetura të akumuluar si dhe ripagimet e tyre çdo tremujor.

¹⁷ Ky është i njëjti për institucionet e qeverisë vendore dhe atyre qëndrore.

Grafiku 12: Shkalla e Realizimit të aktiviteteve në total për Qëllimin Strategjik – III (në %)



Numri i aktiviteteve

Të realizuara 14

Në zbatim 19

Nuk kanë nisur të zbatohen 3

Fillojnë pas 2017 1

Progres më i madh shihet nën objektivin funksione të vetat, i cili ka edhe numrin më të madh të aktiviteteve të realizuara, kundrejt aktiviteteve në total.

Tabela 3: Arritjet kryesore në nivel aktiviteteve

Aktivitete	Nivel Treguesit 2017		
	Vitet bazë 2014/2015	Treguesi Synuar	Treguesi Arritur
Hartimi i ligjit të ri për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore	Nuk ka ligj të miratuar	Ligji i miratuar	Ligji 138/2015
Rishikimi i legjislacionit për shërbimet publike/ndërmarrjet publike në nivel vendor	Ndryshimet e propozuara në legjislacion	Ndryshimet e miratuara	Miratuar ndryshimet ligjore në 7 fusha të shërbimeve
Inventarizimi dhe riklasifikimi i rrjetit të infrastrukturës rrugore urbane dhe rurale.	N/A	50% e inventarit dhe klasifikimit i përfunduar	Përfunduar
Përmirësimi i mekanizmave për të identifikuar dhe vlerësuar nevojat për shërbime të kujdesit shoqëror, sipas procedurave standarde të veprimit dhe metodologjive.	Ndryshimet e propozuara në legjislacion	Miratimi i ndryshimeve të propozuara	Mekanizmat institucionale rregulluar me ligjin nr.121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në RSH"
Lista e shërbimeve sociale të rishikuara e miratuar.	Ndryshimet e propozuara në legjislacion	Miratimi i ndryshimeve të propozuara	8 shërbime sociale të rishikuara
Krijimi i sistemeve të integruara të shërbimeve në nivel rajonal / vendor, bazuar në standardet e shërbimeve shoqërore për të gjitha grupet.	Ndryshimet e propozuara në legjislacion	Miratimi i ndryshimeve të propozuara	Ligji nr.121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në RSH"
Rishikimi i Sistemit të "Ndihmës Ekonomike". Pilotimi i sistemit të ri "pikëzimit" të ndihmës ekonomike.	Ndryshime ligjore të propozuara	Miratimi i ndryshimeve ligjore	VKM nr.456/2016 Për përcaktimin e kriterëve dhe detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e NE".
Rishikimi i ligjit për prefektin me qëllim qartësimin e statusit dhe rolit të prefektin për të shmangur mbivendosjet.	Ndryshimet e propozuara ligjore	Miratimi i ndryshimeve ligjore	Ligji 107/2016
Rishikimi i funksioneve në fushën e rendit dhe mbrojtjes civile duke i përshtatur me ndarjen e re administrative.	Ndryshimet e propozuara ligjore	Miratimi i ndryshimeve ligjore	Ligji 107/2016

4.3.1 Objektivi Strategjik: Funkcionet e qeverisë vendore

A. Infrastruktura vendore dhe shërbimet publike

Në sektorin e ujësjellës-kanalizime reforma po haset me një sërë sfidash. Një nga këto sfida mbetet **konsolidimi i të gjitha shoqërive rajonale ujësjellës-kanalizime** në një ofruar të vetëm për secilën bashki, si dhe bashkëpunimi midis disa bashkive për të kryer një shërbim rajonal UK të përbashkët. Reformat e fundit në sektorin e ujit të miratuar nga Këshilli i Ministrave shtroi kërkesa të tjera: *së pari*, çdo bashki duhet të hartojë një plan tranzicioni të shoqërisë ujësjellës-kanalizime ku të trajtohet procesi i konsolidimit, dhe, *së dyti*, duhet të hartohet një plan 5-vjeçar biznesi ku të trajtohen të gjithë faktorët që ndikojnë në aftësinë e shoqërisë UK për të ofruar shërbim të qëndrueshëm në një mënyrë financiarisht të qëndrueshme, ndërkohë që përdor praktika të shëndetshme biznesi. **U hartuan¹⁸ planet pesë-vjeçare të tranzicionit dhe biznesit për bashkitë Fier, Lushnje dhe Patos, dhe janë në proces planet për bashkitë Tiranë, Vlorë dhe Elbasan.** Qëllimi, siç përcaktohet nga reformat e sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizime, është të sigurohet qëndrueshmëria afatgjate e shoqërisë së çdo bashkie¹⁹. Për të negociuar pritshmëritë e performancës me Ministrinë e re të Energjisë dhe Infrastrukturës duhet që çdo bashki të hyjë në **marrëveshje performance me Agjensinë e MEI-së, ministrinë e linjës për sektorin UK²⁰.** Aktualisht janë nënshkruar 18 marrëveshje ndërmjet AKUK dhe Bashkive, si dhe janë hartuar 6 plane tranzicioni dhe biznesi 5 vjeçar për 6 shoqëri/Bashki për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime të cilat janë përdorur si model edhe nga disa bashki të tjera .

Janë zgjeruar me tej funksionet e NjQV-e në fushën e ujitjes dhe kullimit. U miratua Ligji 24/2017 "Për ujitjen dhe kullimin" që përmbyll procesin e plotë të decentralizimit të këtij funksioni dhe po hartohet strategjia e ujitjes/kullimit. Me qëllim bërjen e skemave të ujitjes më produktive dhe më të qëndrueshme duhet që Drejtoritë e Ujitjes dhe Kullimit dhe bashkitë e reja të punojnë së bashku në partneritet edhe me OPU-të si dhe të rrisin kapacitetet e tyre. **Pavarësisht ecurisë zbatimi i reformës në këtë funksion vazhdon të hasi në problematika si:** (i) bordet e kullimit nuk kanë dorëzuar në çdo rast tek bashkitë ndërtesat, mjetet dhe inventarin; (ii) vijon të ketë paqartësi në "transferimin" e personelit nga bordet e kullimit tek bashkitë; (iii) bashkitë refuzojnë të marrin në dorëzim ndërtesat/mjetet/inventaret në gjendje jo të mirë; (iv) në inventaret e ujitjes dhe kullimit ka objekte (stacion pompimi, etj) të cilat nuk ekzistojnë faktikisht; v) është transferuar funksioni i ujitjes dhe kullimit, por bashkitë nuk zotërojnë asnjë dokumentacion në lidhje me këto funksione; (vi) mungesa e klimës positive së bashkëpunimit në disa raste mes bordeve të kullimit dhe bashkive

Në vitin 2016 ka rifilluar procesi i transferimit të pronave në bashkitë e reja, dhe regjistrimi i tyre duke mundur përdorimin e tyre më shumë në funksion të ekonomive lokale. Me VKM 63, datë 8.3.2016 është aprovuar transferimi 100% i pyjeve dhe kullotave tek 61 bashkitë e reja, duke shfuqizuar mbi 300 VKM të mëparshme për transferimin tek ish-komunat. Aprovimi i këtij vendimi i hap rrugë *menaxhimit të asetëve nga ana e bashkive të reja dhe mundësimin e përdorimit të tyre më shumë në funksion të ekonomive lokale.*

Përfundoi me sukses inventarizimi dhe riklasifikimi i rrjetit të infrastrukturës rrugore urbane dhe rurale, por ende nuk ka progres lidhur me ngritjen e një sistemi të integruar të planifikimit të mirëmbajtjes së rrugëve. Edhe pse i gjithë inventari i rrugëve ka kaluar pranë NjQV, ende nuk ka progres në aplikimin e një sistemi të integruar të planifikimit të mirëmbajtjes

¹⁸ Me ndihmën e projektit PLGP – USAID

¹⁹ Plani 5-vjeçar i biznesit nuk është thjesht një instrument për të siguruar qëndrueshmërinë financiare, por edhe një element kyç për kërkesat e përputhshmërisë së shoqërisë UK. Plani do përdoret: (i) Për të vlerësuar nga pikëpamja sasiore performancën e shoqërisë për një sërë treguesish operationale dhe financiare nga Agjencia për Shoqëritë Ujësjellës-Kanalizime; (ii) Për të siguruar shqyrtimin dhe miratimin e ristrukturimit të tarifave; edhe pse shoqëria është pronë e bashkisë përkatëse, ajo nuk mund të ndryshojë tarifat pa marrë së pari mendimin e Entit Rregullator të Ujit.

²⁰ Është hartuar Udhëzuesi Kombëtar në mbështetje të zbatimit të reformës 63/2016.

së rrugëve në nivel vendor. Në Tetor të 2016 janë aprovuar ndryshimet në ligjin për “**Transportet Rrugore**”²¹ të cilat përcaktojnë funksionet e reja në drejtim të shërbimeve të transportit rrugor duke shtuar kompetencat dhe duke përmirësuar organizimin e shërbimit.²²

Në fushën e mbetjeve urbane, po hartohet draft Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (2017-2024), që parashikohet të miratohet në Trem. 4/2017. Miratimi i dokumentit strategjik do të shoqërohet me rishikimin e kuadrit ligjor përkatës (Ligjit nr.10463/2011 Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve i ndryshuar (2013), dhe akteve të tjera nënligjore). Po punohet për hartimin e Master Planit në fushën e menaxhimit të mbetjeve i cili do të sigurojë rregullimin e rolet e Qeverisë Qëndrore për zbatim dhe investim lidhur veçanërisht me pikat e nxehta të mbetjeve dhe vend-depozimet, landfillet. Është hartuar VKM nr. 652/2016 “Për rregullat dhe kriteret për Menaxhimin e Mbetjeve nga Gomat e Përdorura”. Janë hartuar Planet Vendore të Menaxhimit të Mbetjeve për 6 Bashki.

B. Funksionet në fushën sociale, kulturore dhe sportive

Arsimi parauniversitar: Në mbështetje të zbatimit efektiv të transferimit të punonjësve mësimorë të institucioneve të arsimit parashkollor dhe stafit mbështetës të institucioneve të arsimit parauniversitar, është kryer shtimi i numrit të punonjësve (transferimi +shtesë) me Ligjin Vjetor të Buxhetit. Aktualisht (viti 2017) janë **7,300 edukatore dhe staf mbështetës** që punojnë në institucionet e arsimit parashkollor dhe para-universitar të cilët menaxhohen nga NJQV (199 punonjës më shumë krahasuar me vitin 2016/ ose 2.8% më shumë).

Pavarësisht ecurisë në drejtim të transferimit të personelit reforma në këtë fushë edhe has problematika lidhur me: (i) paqartësi në lidhje me emërimet e mësuesve të arsimit parashkollor; (ii) mungesës së përputhshmërisë ndërmjet numrit të punonjësve të transferuara në disa raste; (iii) paqartësitë lidhur me transferimin e ish QKF; (iv) transferimit të funksionit të transportit të nxënësve dhe mësuesve i cili është akoma i porealizuar në disa raste për shkak të kontratave shtesë të DAR/ZA dhe paqartësive që kanë bashkitë për realizimin e tij; (v) paqartësisë së varësisë së sekretarëve të shkollave dhe punonjëset sociale etj.

Kjo situatë kërkon marrjen e masave nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve për ndryshimin e ligjit “Për Arsimin Parauniversitar” me qëllim finalizimin e procesit të transferimit të funksionit të arsimit parashkollor, duke i kaluar bashkive të drejtën e emërimit të drejtuesve / mësuesve të arsimit parashkollor. Bashkitë duhet të ndërgjegjësohen për faktin që arsimi është një çështje kombëtare dhe si i tillë, ato janë të detyruara të zbatojnë standarte kombëtare të përcaktuara nga ana e MAS, legjislacionin specifik si dhe arrijtjet më të mira të deritanishme, siç është rasti i portalit për arsimin.

Shërbimet sociale dhe të përkujdesit social. Progres i rëndësishëm është shënuar në drejtim të hartimit të kuadrit strategjik e ligjor lidhur me zbutjen e varfërisë, përfshirjen sociale dhe mbrojtjen sociale. U miratua ligji për shërbimet shoqërore ligji nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në RSH”, i cili rregullon mekanizmat institucionale, rolin dhe përgjegjësitë për zbatimin e sistemit të shërbimit të kujdesit shoqëror. Me miratimin e ligjit u miratua edhe lista

²¹ Ligj nr. 10/2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, Datë 18.3.1998, “Për Transportet Rrugore”, të ndryshuar” <https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2015/10/ligj-nr-10-dt-11-2-2016.pdf>. Në vijim të këtij ligji në datën 18.11.2016 ka dal udhëzimi nr. 5627, “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licensave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit.

²² Në këtë ligj ka shtesa kryesisht me: (i) funksionet e reja që i jepen njësisë të vetëqeverisjes vendore në lidhje me pranimin e ndërmarrjeve në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor për të tretë; (ii) shtimin e kompetencave (tarifat e biletave të transportit caktohen me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore); (iii) mënyren e re të organizimit të ndërmarrjeve nëpërmjet detyrimit për t’u regjistruar në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Transportit Rrugor dhe (iv) aplikimet dhe shërbimet e sistemeve inteligjente në transport (SIT).

specifike²³ e shërbimeve sociale që do të ofrohen nga NJQV-të duke prezantuar dhe shpjeguar tipologjinë e shërbimit të ri. Ka filluar puna për hartimin e standarteve të shërbimeve dhe kostove për njësi, proces i cili pritet të përfundojë në vitin 2018. Me ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në RSH” është krijuar baza ligjore për krijimin e sistemeve të integruara të shërbimeve në nivel rajonal / vendor, bazuar në standartet e shërbimeve shoqërore për të gjitha grupet. Ligji përcakton ngritjen e **Regjistrimit Elektronik Kombëtar**, i cili do të jetë i aksesueshëm nga të gjitha NJQV-të. Ndërkohë ka filluar puna për përcaktimin e “workflow” të shërbimeve.

Ka nisur procesi i krijimit të sistemeve të integruara të shërbimeve në nivel rajonal / vendor, bazuar në standartet e shërbimeve shoqërore për të gjitha grupet. Është kryer rishikimi i Sistemit të Ndihmës Ekonomike dhe Pilotimit. U miratua Vendimi nr. 956, datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve dhe detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e Ndihmës Ekonomike”. Pilotimi përfundoi në Qershor 2017 dhe zbatimi i tij i plotë parashikohet në Tetor 2017.


Në fushën e Kulturës ende nuk ka progres të dukshëm lidhur me rishikimin e kuadrit ligjor për qartësimin e funksioneve dhe përgjegjësi në fushën e Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore, si dhe ngritjen e një sistemi të integruar të zhvillimit të zonave dhe objekteve të trashëgimisë kulturore në nivel vendor. Në kuadër të decentralizimit të disa funksioneve në NJQV, është kryer transferimi i disa qendrave për fëmijë, kompetencë e Ministrisë së Kulturës në disa Bashki. Ligji për Trashëgiminë Kulturore është hartuar por ende nuk është miratuar.

C. Zhvillimi ekonomik vendor

Ka vijuar puna me hartimin e Planeve të Përgjithshme Vendore të Zhvillimit të Territorit, edhe pse ky proces vazhdon me ritme të ndryshme sipas fazave në të cilat ndodhen bashkitë. Në fund të dhjetorit 2016 Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT) miratoi PPV-të e pesë bashkive konkretisht: Berat, Kuçovë, Fier, Lushnje, dhe Elbasan. Aktualisht numri i PPV të miratuara ka arritur në 26 ose 63% të bashkive.

Menaxhimi i Pyjeve dhe Kullotave: Në kuadër të decentralizimit të plotë të funksionit të administrimit dhe menaxhimit të pyjeve dhe kullotave është hartuar baza ligjore²⁴ që mundësoi transferimin e funksionit. Janë hartuar dhe kanë kaluar procesin e konsultimit publik dhe diskutimin në komisionin parlamentar dy draft ligje²⁵ dhe pritet miratimi i tyre përfundimtar nga Parlamenti, brenda vitit 2016. Me transferimin e funksionit në NJQV, **82.3% e**

Figura 1: Planet e Përgjithshme Vendore



²³ Lista e shërbimeve shoqërore është miratuar si pjesë integrale e ligjit nr.121/2016 që përmban: 1.Shërbime sociale financiare për familjet në nevojë; 2.Shërbime sociale për fëmijë; 3.Shërbime multidisiplinare për fëmijët; 4.Shërbime për persona me aftësi të kufizuar; 5.Shërbime sociale për të moshuar; 6.Shërbime multidisiplinare për të rinjtë; 7.Shërbime sociale për gra, vajza apo fëmijë të dhunuar; 8.Shërbime për viktimat e trafikuar.

²⁴ Urdhëri i KM Nr.127, datë 16.09.2016), pika 6, për funksionin e menaxhimit të pyjeve dhe kullotave” dhe VKM nr.438, datë 08.06.2016 për “Kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe shitjes së materialit drusor”, VKM 435 datë 08.06.2016 për disa shtesa dhe ndryshime në VKM 1374/2008 të KM “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”, VKM 433 dt. 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, pronë e MoE dhe ish komunave”.

²⁵Projekt ligji për “Administrimin e Fondit Pyjor dhe Kullor në RSH”. Projekt ligji për “Shpalljen e Moratoriumit të Gjuetisë në RSH”.

sipërfaqes së fondit pyjor dhe kullor ka kaluar në administrimin e Bashkive, 15% e sipërfaqes i përket zonave të mbrojtura dhe 2.7% janë pyje private. Ministria e Mjedisit ka inkurajuar Bashkitë për të shfrytëzuar të gjitha asetet e pyjeve. Në periudhën Shkurt-Qershor 2017 është hartuar dhe zhvilluar një program trajnimi (dy ditor) për stafin e shërbimit pyjor në të gjitha bashkitë, ku janë trajnuar rreth 447 punonjës të profesionit pyjor dhe jurist. Në vitin 2017, **fondi per investime u rrit me 5% krahasuar me vitin 2016. Ka filluar rregjistrimi i fondit pyjor në kuadër të unifikimit të rregjistrimit kadastral kombëtar. Në fazën e parë (përfundon në 2017) do të kryhet rregjistrimi i 250,000 ha, ndërsa në 2018-2019 do të kryhet rregjistrimi i rreth 750,000 ha pyje dhe kullota.**

Pavarësisht progresit ky funksion ka hasur disa problematika: (i) paqartësi në buxhetin e transferuar (buxheti i transferuar përmban vetëm fond page për disa persona, ndërkohë nga ana e Ministrisë së Mjedisit kërkohet një personel disa herë më i madh për këtë shërbim; (ii) ndërmarrjet e shërbimit pyjor qendrojnë të mbyllura, ndërkohë që bashkitë kanë nevojë për ndërtesën, mjetet dhe dokumentacionin që është bllokuar brenda tyre; (iii) paqartësia e kompetencave të bashkive për pyjet dhe kullotat; (iv) funksionimi i dy inspektoriateve ai qendror dhe ai vendor; (v) mungesa e saktësisimit me koordinata të kufirit të çdo pylli dhe kullote dhe (vi) problematika në marrjen në dorëzim të inventareve që nuk përputhen me realitetin (pyje të prerë ose të djegur, parcela që nuk ekzistojnë, etj.).

Mbrojtja e mjedisit: Po hartohet draft Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (2017-2024), që parashikohet të miratohet fund të vitit 2017. Miratimi i dokumentit strategjik do të shoqërohet me rishikimin e kuadrit ligjor përkatës (ligjit nr.10463/2011 për menaxhimin e integruar të mbetjeve i ndryshuar (2013), dhe akteve të tjera nënligjore). Po punohet për **hartimin e Master Planit** në fushën e menaxhimit të mbetjeve i cili do të sigurojë rregullimin e rolet e Qeverisë Qendrore për zbatim dhe investim lidhur veçanërisht me pikat e nxehta të mbetjeve dhe vend-depozimet, landfillet. Është hartuar VKM nr. 652/2016 “Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve nga gomat e përdorura”. Janë hartuar Planet Vendore të Menaxhimit të Mbetjeve për 6 Bashki partnere.

Gjatë kësaj periudhe, fokusi është përqëndruar në ngritjen e kapaciteteve njerëzore për mbrojtjen e mjedisit. Gjatë vitit 2017 po përmirësohet sistemi i grumbullimit të të dhënave të sektorit nëpërmjet aplikimit të sistemit të *benchmarking*, i cili fillimisht ka nisur në disa bashki në veri të Shqipërisë dhe më pas do të vijohet me cikël trajnimesh për rritjen e kapaciteteve të bashkive për sistemin e benchmarking në të gjithë vendin.

Në drejtim të rishikimit të funksioneve në fushën e rendit dhe mbrojtjes civile është miratuar VKM nr.366,dt.18.05.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pronave të paluajtshme dhe të luajtshme shtetërore të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit dhe për disa ndryshime të vendimit nr.1691, datë 10.10.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme”. Por edhe pse ka pasur progres ende ka probleme lidhur me (i) transferimin e plotë të objekteve të shërbimit të zjarrfikjes dhe shpëtimit, pasi bashkitë nuk mund të ofrojnë këtë shërbim duke financuar për objekte dhe mjete që nuk i kanë në pronësi; (ii) paqartësi në lidhje me territorin që mbulojnë zjarrfikëset e bashkive dhe si do funksionojë ky shërbim tani që është transferuar tek bashkia; (iii) detyrimet e prapambetura për automjetet zjarrfikëse lidhur me taksa/kontrolle teknike/siguracione prej disa vitesh të papaguara; (iv) plotësimi me akte nënligjore; (v) paqartësitë e mbullimit të kostos në rastet kur shërbimi zjarrfikës i një bashkie shërben në territorin e bashkisë tjetër; (vi) pozicionimi i strukturës së këtij shërbimi në atë të bashkisë. Kjo situatë kërkon ndërhyrje ligjore dhe organizative për të sqaruar dhe adresuar problemet e dala.

Rishikimi i ligjit të Prefektit ishte një nga arritjet drej eliminimit të mbivendosjes së kompetencave ndërmjet strukturave të dekoncentruara në nivel vendor dhe strukturave të


qeverisjes vendore. Përfundoi procesi ligjor për rishikimin e funksioneve në fushën e rendit dhe mbrojtjes civile duke i përshtatur me ndarjen e re administrative.

4.4 Progresi i arritur në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë në nivel vendor dhe zbatimit të të drejtave të qytetarëve

Në kuadër të këtij aktiviteti, në vitin e parë të zbatimit të strategjisë gati 60% e aktiviteteve, ose në total 32 nga 54 aktivitete kanë filluar të zbatohen dhe 18 prej tyre janë realizuar gjatë 2016, por një pjesë e mirë e tyre janë planifikuar të fillojnë gjatë vitit 2017 (shih grafikët më poshtë).

Progres më i mirë vihet re në realizimin e aktiviteteve që lidhen me arritjen e objektivit strategjik të Zhvillimit të kapaciteteve të njësive të qeverisjes, ku është parashikuar edhe numri më i madh i aktiviteteve për këtë qëllim strategjik. **Në kuadër të këtij objektiv janë realizuar 17 aktivitete. Ndërkohë paraqiten me vonesë në fillimin e tyre 5 aktivitete.**²⁶

Grafiku 13: Shkalla e realizimit të aktiviteteve në total për qëllimin strategjik – IV (në numër dhe %)



Të realizuara 17

Në zbatim	27
Nuk kanë nisur të zbatohen	9
Fillojnë pas 2017	1


4.4.1 Objektivi Strategjik: Zhvillimi i kapaciteteve të njësive të qeverisjes

Ecure pozitive, shënohet në drejtim të vlerësimit të nevojave për trajnim dhe hartimit të planit kombëtar të trajnimeve. Përfundoi metodologjia e vlerësimit të nevojave të trajnimit për të mbështetur performancën e funksioneve të reja të transferuara tek NJQV. Metodologjia e VNT bazohet në vlerësimin sipas kompetencave për çdo funksion dhe është e lidhur me vlerësimin e arritjeve në punë.

Ka vazhduar me sukses ngritja dhe trajnimi i

NJBNI në çdo administratë të re bashkiake, si njësi që do të përgatisin dhe realizojnë procesin e tranzicionit. SHAP ka miratuar 2 programe 1 vjeçare trajnimi të vazhduar për vitin 2016 në fushat e: 1) Menaxhimit të Mbetjeve Urbane dhe 2) Menaxhimit të Financave Publike.

Grafiku 14: Të dhëna krahasuese mbi trajnimet e kryera



Burimi : SHAP

²⁶ 61 bashkitë janë trajnuar për procedurat e riorganizmit administrativ; NJQV-ve që kanë lidhur sistemin HRMIS me sistemin e thesarit; rishikimi i akteve ligjore, marrëveshjet e bashkëpunimit me dhomat e tregëtise dhe ngritja e databazës elektronike.

Dldp është në proces të vlerësimit të cilësisë së kurrikulës së trajnimit për ofrimin e shërbimeve administrative ndërmjet Zyrave me Një Ndalesë, të cilat po vazhdojnë të zbatohen.

Progres është arritur në krijimin e arkivës dhe librarisë elektronike të materialeve të trajnimit për qeverisjen vendore. Janë duke u përgatitur standartet dhe kriteret për sistemin e vlerësimit të cilësisë së kurrikulave dhe trainerëve. Ka pasur ecuri në drejtim të përfundimit të platformës " e-Library" me kurrikulat që kanë kaluar procesin e vlerësimit të cilësisë. SHAP ka publikuar një katalog të materialeve për trajnimin e punonjësve të qeverisjes vendore dhe ka vijuar me vlerësimin e një pjese të kurrikulave ekzistuese.

Ka vijuar mbështetja ndaj bashkive për ngritjen e kapaciteteve për realizimin e vlerësimeve të punës nga NjQV. DAP ka hartuar manualët dhe udhëzimet për vlerësimin e punës dhe sistemin e klasifikimit të vendeve të punës i dedikuar për NjQV. Është mbajtur trajnimi për vlerësimin e arritjeve në punë për stafet e NJMBNJ të bashkive dhe në muajin nëntor 2016 projekti i KiE do të ofrojë një trajnim të avancuar, me qëllim që të mundësohet kryerja e vlerësimit të arritjeve në punë në fund të vitit 2016. Nëpërmjet sistemit E-PAV do të mundësohet ofrimi i të dhënave mbi numrin e punonjësve që kalojnë procesin e vlerësimit deri në fund të muajit qershor 2016 si dhe të paraqiten rezultatet e këtyre vlerësimeve.

Gjatë këtij viti, konstatohen tendenca të rritjes së nivelit të zbatimit të institutit të rekrutimit në grup Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil edhe në institucionet e administratës vendore dhe institucioneve të pavarura, të cilat një vit më parë kanë qenë problematike në këtë drejtim²⁷. Nisur nga situata e konstatuar gjatë mbikëqyrjes, si dhe nga komunikimi i vazhdueshëm me institucionet që veprojnë në fushën e shërbimit civil, komisioneri e vlerëson në një nivel të mirë zbatimin e ligjit nr. 152/2012, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar. Ajo që mund të konstatohet si një problem që ka filluar të shfaqet sërish, edhe pse një vit më parë ka qenë në nivele të ulëta, është rekrutimi në kundërshtim me ligjin, nëpërmjet kontratave të përkohshme. Ky fenomen tashmë është evident në institucionet e administratës vendore.

Vëmendje i është kushtuar dhe adresimit të problemeve të barazisë gjinore nëpërmjet mbështetjes së dhënë të angazhimit të grave në politikë nëpërmjet mbështetjes së Rrjetit të Këshilltarëve Bashkiake. Në Bashkinë Durrës me mbështetjen e Dldp është ngritur në muajin Dhjetor 2016 "Aleanca e Këshilltarëve Bashkiake Femra, si dhe janë mbashtetur 5 bashki në hartimin e buxheteve që adresojnë barazinë gjinore.

4.4.2 Objektivi Strategjik: Sigurimi i një qeverisje të hapur, rritjes së transparencës, llogaridhënies dhe shtrirjes më të madhe të qeverisjes në nivelin vendor.

Përveç progresit të bërë në drejtim të krijimit të lehtësirave për qytetarët për marrjen e informacionit dhe shërbimeve, siç përmendët më lartë nëpërmjet hapjes së zyrave më një ndalesë ("one stop shop") **progres i mëtejshëm është bërë lidhur me përdorimin e mjeteve të TIK për ofrimin e informacionit me publikun.** Numri i bashkive me faqe interneti është rritur nga 24 (39%) në 48 (79 %) bashki²⁸. Gjithashtu media sociale po përdoret në gjerësi nga bashkitë si mënyrë për shpërndajen e informacionit dhe komunikimit me publikun.

Megjithëse, po i jepet gjithnjë e më shumë rëndësi dhe vëmendje përdorimit të faqeve të internetit si mjet komunikimi me publikun, jo të gjitha bashkitë i kushtojnë vëmendje rifreskimit të informacionit, si dhe përdorimit të tyre si mjet i rëndësishëm i transparencës me publikun. Vetëm

²⁷ Raport Për veprimtarinë e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil – 2016, Shkurt 2017

²⁸ Nga vlerësimi i ndërmarrë deri në 5 Shtator 2017, rezultoi se nga 61 bashki vetëm 48 prej tyre kanë faqe interneti. Prej tyre, 37 kanë faqe me domain institucional ".gov.al" (me ngjyrë jeshile në hartë), kurse 11 bashki kanë faqe, por me domain të zakonshëm (.org ose .com ose .al). Nga vlerësimi i ndërmarrë nga InfoCIP, rezultoi se në vitin 2017, janë vetëm 13 bashki që nuk kanë akoma një faqe zyrtare interneti (shënuara me ngjyrë të kuqe në hartë). (Shih: MONITORIMI 2017 - Implementimi i të drejtës së informimit nga Bashkitë e Shqipërisë, realizuar nga InfoCIP)

25 bashki, nga 48 që kanë faqe interneti, kanë të afishuar në faqen zyrtare të internetit regjistrin e pyetje përgjigjeve, ndërsa lidhur me përditësimin e tyre rezultojn vetëm me 16 regjistra të përditësuar nga 25²⁹ gjithësej. Me fjalë të tjera, gjatë 2017-s, ka 22 bashki më shumë sesa në vitin 2016 që kanë një regjistër të pyetje-përgjigjeve.

Figura 2: Bashkitë me koordinator të informimit






Figura 3: Bashkitë që publikojnë vendimet



Gjithashtu progres ka pasur në zbatimin e detyrimit ligjor për caktimin e koordinatorit të informimit³⁰ duke pësuar një rritje nga 42 bashki në 58 bashki (ose 68.8% e tyre) që kanë caktuar në këtë funksion. Vetëm 3 bashki nuk e kanë ende një koordinator (Tropoja, Finiqi dhe Këlcyra). Por duhet përmendur se në të 48 Bashkitë që kanë faqe interneti, vetëm në 31 prej tyre janë të publikuara edhe kontaktet e koordinatorëve³¹, edhe pse duhet theksuar se të dhënat e tyre janë të afishuara edhe në portalin www.pyetshtet.al. Ndërsa programi i transparencës publikohet në 43 nga 48 bashkitë që kanë faqe interneti.

Është rritur mjaft ndjeshëm numri i bashkivë që publikojnë vendimet on-line. Nga vetëm 14 bashki ose 22% në vitin 2016, tashmë 41 prej tyre publikojnë vendimet e këshillit bashkiak (67.2%), ç'ka përbën një zhvillim për t'u përgëzuar³².

Gjithashtu po aplikohen praktika inovative të marrjes së opinionit qytetar nëpërmjet hapsirave të dedikuara me titull “Përmirëso qytetin tim” në faqet zyrtare të internetit të disa bashkive, dhe aplikacione si “Tirana ime”, ku qytetarët mund të ndajnë të dhëna dhe sugjerime për përmirësimin e qeverisjes vendore.



Platforma “Përmirëso Qytetin” (www.permiresoqytetin.al) prezantuar më 15 prill 2016 është një projekt i qeverisë për t’ju ardhur në ndihmë të gjitha bashkive, ku secila

²⁹ Janë 9 regjistra të cilat përditësimin e fundit e kanë marrë në vitin 2016. Këto regjistra i takojnë bashkive Krujë, Kamëz, Elbasan, Gramsh, Vlorë, Kavajë, Peqin, Kukës Pogradec. (Shih InfoCIP, 2017)

³⁰ Ligji 119/2014 vendos detyrimin për caktimin e koordinatorëve të informimit.

³¹ Bashkitë që nuk i kanë të publikuara janë Belshi, Dibra, Divjaka, Klosi, Mallakastër, Memaliaj, Tropoja, Mirdita, Kurbini, Finiqi, Tepelena, Vau Dejës.


³² Deri në vitin 2012, asnjë bashki, me përjashtim të Tiranës, nuk publikonte vendimet e këshillit bashkiak në asnjë lloj forme të njohur. Kurse në vitin 2016, vetëm 20% e gjithë bashkive të Shqipërisë publikonin vendimet e veta. Rreth 87% e tyre, publikonin përmes platformës kombëtare VENDIME.AL I krijuar dhe mirëmbajtur nga INFOÇIP.

prej tyre do të ketë mundësinë të evidentojë me anën e raportimit të qytetarëve problematika të ndryshme. Modernizimi dhe përdorimi i teknologjisë janë mënyra më e mirë për të përmirësuar shërbimin dhe ulur burokracinë e korrupsionin.

Monitorimi i shoqërisë lidhur me rritjen e transparencës së NjQV, vazhdon të kryhet në mënyrë konstatante. Më lartë janë paraqitur të dhënat nga monitorimet të kryera nga organizata InfoCIP. Gjthashtu në kuadër të programit Lëviz Albania, organizat të shoqërisë civile kanë monitoruar performancën e bashkive lidhur me transparencën edhe me zbatimin e funksioneve.

Organizata BIRN, realizoi fazën e dytë të monitorimit lidhur me nivelin e transparencës së bashkive. Të dhënat e monitorimit tregojnë se niveli mesatar i transparencës për të 61 bashkitë e vendit në vitin 2017 është 46%, vetëm 3% më lart se niveli i transparencës së monitoruar në vitin 2016. Gjetjet tregojnë se bashkitë janë më transparente lidhur me dokumentacionet dhe informacionin nën kategorinë “E drejta e Informimit” dhe “Këshilli Bashkiak”, ndërsa kategoritë të cilat janë më pak transparente në nivel kombëtar janë “Transparenca Financiare” dhe “Legjislacioni”.

Figura 4: Vlerësimi i zbatimit të të drejtës së informimit



4.4.3 Objektivi Strategjik: Integrimi evropian dhe qeverisja vendore

Një vemendje e rëndësishme i jepet forcimit të rolit të qeverisjes vendore në procesin e integrimit evropian dhe rritjes së kapaciteteve për përthithjen e fondeve të BE-së.

Shkolla e Administratës Publike me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, nëpërmjet projektit “Fuqizimi i kapaciteteve të shoqërisë civile dhe administratës lokale për përvetësimin e fondeve të BE-së”, ka zhvilluar gjatë muajve **Tetor – Dhjetor 2016, Maj-Qershor 2017 tre raunde të trajnimeve** me Njësitë e Pushtetit Vendor në disa prej qarqeve të vendit, ku janë **trajnuar 168 persona**. Këto trajnime synuan rritjen e kapaciteteve të bashkive për përthithjen e asistencës financiare që ofrohet pikërisht nëpërmjet këtyre fondeve³³. Trajnimet e zhvilluara në këtë sesion ishin pjesë e raundit të tretë të trajnimeve të organizuara në kuadër të projektit për “Fuqizimin e kapaciteteve të shoqërisë civile dhe administratës lokale për përvetësimin e fondeve të BE-së”. Raundi i katërt i trajnimeve do të vijojë edhe përgjatë gjysmës së dytë të vitit 2017. Raundi i katërt i trajnimeve do të fillojë në Tetor 2017.

Gjatë kësaj periudhe kanë nisur zbatimin dy projekte të rëndësishme të financuar nga Bashkimi Evropian të cilat synojnë forcimin e rolit të bashkive në drejtim të menaxhimit të procesit të integrimit në nivelin vendor, dhe rritjen e bashkëpunimit me shoqërinë civile.

³³ Informacioni i detajuar jepet në faqen e projektit *EU for Albania* <http://euforalbania.info/al/trajnime>

“**Bashkitë për Evropën**³⁴ është projekti i ri i financuar nga Bashkimi Evropian në Shqipëri me synim mbështetjen e ngritjes së një zyre evropiane lokale në secilën prej 61 bashkive. Projekti u prezantua gjatë punimeve të konferencës “Roli i qeverisjeve vendore në procesin e integritimit në BE”, organizuar nga Instrumenti i BE-së për Asistencë Teknike dhe Shkëmbim Informacioni (TAIEX) në bashkëpunim më zyrën e Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore në 5 Dhjetor 2016. Lidhur me projektin u firmos një Memorandum Mirëkuptimi mes kryebashkiakëve dhe anëtarëve të qeverisë shqiptare.

Ndërsa përmes programit **ReLOaD** synohet të forcohet partneritetet ndërmjet qeverive lokale dhe shoqërisë civile në Shqipëri, përmes skemës së granteve dhe aktiviteteve të ndërtimit të kapaciteteve. Kjo do të realizohet duke përmirësuar një model të suksesshëm të financimit transparent dhe të bazuar në projekte të organizatave të shoqërisë civile nga buxhetet e qeverisë lokale drejt një angazhimi më të madh qytetar në vendimmarrjen dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve lokale.

³⁴ Projekti do të sjellë më pranë qytetarëve shqiptarë dhe administratave vendore më shumë informacion mbi BE-në, politikat dhe programet e saj. Ndërsa fokusi do të jetë sigurimi i njohurive mbi BE-në, veçanërisht si të rritet kapaciteti përthithës i autoriteteve të qeverisjes vendore në Shqipëri për fondet dhe programet evropiane, do të ketë aktivitete që synojnë të lehtësojnë ndërlidhjen dhe ndarjen e përvojave mes bashkive dhe dialogun me qeverinë qendrore dhe Delegacionin e BE-së.

5 Sidat e realizimit të strategjisë

- *Zbatimi i planeve të përgjithshme vendore të territorit, proces i cili po has vështirësi lidhur me: (i) mungesën e burimeve financiare; (ii) mundësitë dhe kapacitetet e kufizuara të bashkive në grumbullimin e përpunimin e të dhënave mbi territorin dhe pronësitë (iii) mungesa e sistemit të integruar të informacionit në bashki; (iv) kapaciteteve jo të mjaftueshme për vlerësimin e shërbimeve dhe realizimin e studimeve të mundura, si dhe (v) vështirësitë për të rekrutuar personel të kualifikuar;*
- *Zbatimi me efektivitet i Ligjit për Financat e Vetëqeverisjes Vendore, duke përfshirë këtu përfundimin e akteve nënligjore dhe procedurave të nevojshme për ndarjen e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale;*
- *Plotësimi i reformës së decentralizimit fiskal të filluar me Ligjin për Financat e Vetëqeverisjes Vendore, duke adresuar problemet strukturore në administrimin e taksave dhe tarifave vendore, duke filluar nga Kadastra/Regjistri Fiskal i pasurive të paluajtshme;*
- *Diskutimi dhe konsultimi i hapur mbi reformën e sistemit të taksimit të pasurive të paluajtshme me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe grupet e tjera të interesit;*
- *Rritjes së kapaciteteve të NJQV, që të përdorin huamarrjen dhe borxhin për financimin e investimeve kapitale brenda politikave kombëtare të borxhit publik.*
- *Aplikimin e një sistemi të integruar të planifikimit të mirëmbajtjes së rrugëve në nivel vendor me synim rritjen e efikasitetit të investimeve në infrastrukturën rrugore;*
- *Forcimi më tej i bashkëpunimit ndërmjet ministrive sektoriale dhe bashkive lidhur me zbatimin e funksioneve në fushat përkatesë, pasi ende ka shumë paqartësi në zbatimin e funksioneve në fushën e arsimit, ujitjes dhe kullimit, mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, pyjeve dhe kullotave dhe rrugëve rurale;*
- *Menaxhimi më eficient i financave vendore: forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve teknike dhe njerëzore të administratës vendore për planifikimin e burimeve njerëzore dhe përparësimin e buxhetit afat-mesëm (PBA), sigurimin e menaxhimit financiar transparent dhe efektiv dhe mirë administrimin e të ardhurave vendore;*
- *Zvogëlimi i nivelit të detyrimeve të prapambetura dhe atyre të reja të krijuara rishtazi;*
- *Zbatimi efektiv i Ligjit të Shërbimit Civil: Krijimi i një administrate vendore të depolitizuar, të paanshme dhe profesionalisht të aftë për të siguruar mirëqeverisjen vendore dhe ofrimin efektiv dhe cilësor të shërbimeve publike për qytetarët;*
- *Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve teknike dhe njerëzore për njësitë e reja organizative të krijuara në nivel Bashkie për zbatimin e funksioneve të transferuara pranë tyre;*
- *Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe monitorimi i tyre nga qeveria dhe qytetarët bazuar mbi ofrimin kundrejt standarteve minimale kombëtare që duhet të hartohen për të gjithë shërbimet dhe që do të jenë të detyruara për t'u respektuar nga të gjitha Bashkitë;*
- *Rritja e bashkëpunimit ndërmjet bashkive dhe komunitetit të biznesit: ndërrmarja e projekteve të përbashkëta nëpërmjet iniciativave të financuara bazuar në partneritetin – publik-privat;*
- *Zvogëlimi i pabarazisë në aksesin në shërbime në raportin urban-rural. Garantimi i barazisë në ofrimin e mallrave dhe shërbimeve publike cilësore mund të ndihmojë në barazimin e mundësive, mund t'i lejojë individëve që të rrisin kapitalin njerëzor, siç është arsimit, shëndetësia dhe aftësitë; kapitalin financiar edhe në zonat rurale;*

- *Forcimi i mekanizmave të llogaridhënies dhe menaxhimit e trajtimit e ankesave të qytetarëve.* Duhet të hartohet një sistem i unifikuar për menaxhimin e ankesave sipas një sistemi të bazës së të dhënave që lejon jo vetëm gjurmimin e ankesave, por edhe kategorizimin dhe analizimin e tipologjisë së tyre për zhvillimin e politikave në të ardhmen.

6 Aktivitetet kryesore deri në fund të vitit 2017

Ndërkohë që vazhdon puna për zbatimin e një sërë aktivitetesh të parashikuara në planin e veprimit, deri në fund të vitit 2017 pritet të realizohen aktivitetet e mëposhtme:

- Miratimi i ndryshimeve të Rregullores së Planifikimit të Territorit;
- Ngritja e Këndeve të Bashkimit European në të 61 bashkitë e vendit;
- Fillimi i procesit të vlerësimit të performancës së bashkive lidhur me zbatimin e reformave që lidhen me integrimin european në nivelin vendor;
- Përgatitja e akteve nënligjore pas miratimit të ligjit "Për financat e veteqeverisjes vendore";
- Hartimi dhe miratimi i ndryshimeve ligjore në ligjin "Për sistemin e taksave vendore";
- Transferimi i Pronës - Pika C: Zhvillimi i rregulloreve vendore për menaxhimin e aseteve të NJQV të reja;
- Fillimi i projektit për mbështetjen nga projekti STAR2 të 34 bashkive të përmbushin kërkesat ligjore, standartet për transparencën e vendimeve të Këshillit Bashkiak.

7 Metodologjia e monitorimit dhe raportimit


SKNDQV 2015-2020 përcakton se zbatimi i strategjisë do të shoqërohet me një proces monitorimi të vazhdueshëm me qëllim që të sigurohet arritja e objektivave të parashikuara. I gjithë procesi i monitorimit dhe vlerësimit udhëhiqet në nivel politik nga Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore.

Strategjia përfshin dy instrumenta kryesorë monitorimi dhe vlerësimi:

1. **Plani i Veprimit i Zbatimit të SKNDQV 2015-2020**, i cili shërben për monitorimin e arritjeve dhe të ecurisë në proces, përmes matjes së veprimeve dhe rezultateve brenda kohës së programuar. Plani i Veprimit përfshin gjitha komponentët, me objektiva specifike, veprimet e parashikuara, afatet kohore, kushtet dhe përgjegjësitë për zbatimin e tij.
2. **Matrica e Treguesve të Performancës** e cila përfshin treguesit bazë që do të përdoren për monitorimin e performancës dhe arritjeve të politikave në fusha të ndryshme, si politika fiskale, reforma administrative – territoriale, etj.

Monitorimi i strategjisë parashikon kryerjen e procesit të monitorimit në nivel tre shkallësh dhe realizimin e tij në tre afate kohore të caktuara:

Figura 5: Sistemi i Monitorimit dhe Vlerësimit



Ky raport monitorimi fokusohet në analizën e tij në dy nivele:

1. Paraqet në pjesën narrative arritjet kryesore të zbatimit të strategjisë për periudhën korrik 2016 – korrik 2017
2. Paraqet në mënyrë progresive realizimin e secilit aktivitet që nga koha e aprovimit të strategjisë (korrik 2015) deri në % periudhën aktuale.

Duke qenë se strategjia parashikon edhe një matje të arritjeve në fushat e reformave të ndryshme, bazuar në treguesit e performancës, për një pjesë të tyre raporti paraqet arritjet deri në mesin e vitit 2017 duke synuar ta krahasojë arritjen e treguesve në periudhën afatmesme të vlerësimit të zbatimit të strategjisë. Duhet përmendur se për një vlerësim më të saktë të arritjeve do të duhet që matja dhe raportimi i treguesve të kryhet në fund të vitit 2017.

Mbledhja e të dhënave

Procesi i mbledhjes së informacionit filloi në muajin Gusht 2017 dhe përfundoi në muajin tetor 2017. Procesi i mbledhjes së informacionit, monitorimit dhe vlerësimit të ecurisë fillimisht u koordinua nga Kabineti i Ministrisë së Shtetit për Çështjet Vendore i cili kryente edhe rolin e koordinatorit ndërsektorial të procesit të zbatimit dhe monitorimit të Strategjisë, dhe më pas nga Ministria e Brendshme, e cila me krijimin e strukturave të Qeverisë, në Shtator 2017 është e ngarkuar edhe me funksionet e decentralizimit dhe qeverisjes vendore. Një kontribut të rëndësishëm në ofrimin e informacionit dhanë ekipet e projekteve që mbështesin zbatimin e reformave në fushën e qeverisjes vendore: Programi për Zhvillim Vendor dhe Decentralizim, Projekti i USAID-it për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore, Projekti i Këshillit të Europës dhe

Projekti STAR. Veç informacionit të mbledhur nga burimet e mësipërme të informimit, u shfrytëzuan një sërë të dhënash të grumbulluara nëpërmjet informacioneve të publikuara në faqet e internetit të ministrive të ndryshme dhe agjencive qendrore. Gjithashtu, u shfrytëzuan edhe raportet e monitorimit të hartuara në kuadër të strategjive të tjera sektoriale të cilat përfshinin aktivitete të cilat lidheshin më funksionimin dhe aspekte të ndryshme të qeverisjes vendore. Si një burim i rëndësishëm informacioni u shfrytëzuan dhe raporte monitorimi të shoqërisë civile apo organizatave ndërkombëtare që operojnë në vend. Gjithashtu nëpërmjet ekspertëve të kontraktuar nga Programi Dldp, një sërë intervistash u realizuan me përfaqësues të ndryshëm të ministrive të linjës.

Kriteret e vlerësimit

Metodologjia e vlerësimit e aplikuar bazohet në vlerësimin e shkallës së realizimit të aktiviteteve. Duke qenë se aktivitetet e parashikuara në planin e veprimit shtrihen në tre faza, për qëllime të vlerësimit të ecurisë së realizimit të tyre është mbledhur dhe vlerësuar informacioni për secilin nga aktivitetet pavarësisht nga afatet e parashikuara të fillimit e përfundimit të tyre. Nga ky vlerësim rezultoi së një sërë aktiviteteve kishin filluar përpara kohës së parashikuar në dokumentin e Planit të Veprimit 2015-2020.

Bazuar në informacionin e mbledhur u realizua vlerësimi i ecurisë i cili mbajti parasysh vlerësimin e ecurisë bazuar në 2 kriteret vlerësimi:

1. Vlerësimi të statusit të fillimit të aktivitetit: (i) nëse aktiviteti kishte filluar nga zbatimi i tij; (ii) nëse aktiviteti nuk kishte filluar të zbatohet dhe (iii) nëse aktiviteti parashikohej të fillonte pas vitit 2016. Brenda kësaj kategorie u përfshinë aktivitete të cilat sipas planit parashikoheshin të fillonin pas vitit 2017, ose parashikoheshin të fillonin në vitet 2015-2017, por që për arsye të caktuara fillimi i tyre ishte shtyrë për periudha të mëvonshme;
2. Shkalla e realizimit të aktivitetit: bazuar në këtë kriter aktivitetet të cilat kishin filluar të zbatoheshin u vlerësuan lidhur me shkallën e përmbushjes së tyre duke i klasifikuar në dy grupe: (i) të realizuara plotësisht dhe (ii) të realizuara pjesërisht.

Përfundimi i raportit dhe prezantimi i gjetjeve

Raporti përfundoi në fund të muajit Tetor 2017. Raporti i monitorimit do të bëhet publik dhe do të ndahet për informim nëpërmjet faqes së internetit të zyrës së Ministrisë së Brendshme.

8 Statusi i zbatimit të planit të veprimit 2015-2020 deri në tetor 2017

Nr	Objektivat/Masat	Afatet e Zbatimit	Treguesit e Rezultatit (Produktet)	Progresi i arritur deri në realizimin e aktiviteve deri në 2017			Treguesit e Suksesit		
				Realizuar	Në zbatim	Nuk ka filluar ende	Treguesi Krahasues	Synimi	Arritja
							Treguesi i Vitit Bazë	2017	2017
Qëllimi Strategjik I. Rritja e efikasitetit në tërësi të strukturave të qeverisjes vendore									
Objektivi Strategjik I.1 Reforma Administrativo-Territoriale									
Objektivi Specifik I.1.1		Konsolidimi administrativ dhe financiar i 61 bashkive të reja pas miratimit të ligjit të ri për ndarjen administrativo-territoriale;							
Treguesi i Performances		Indeksi i inventarizimit te aseteteve			2014	50%	70%		
I.1	Ngritja dhe funksionimi i Agjencisë së Zbatimit të Reformës Territoriale	2015-2020	-VKM për ngritjen e AZRT Nr. i personelit të emëruar	- VKM Nr. 83, datë 28.1.2015. Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zbatimin e Reformës Territoriale. - 14 persona të emëruar ³⁵ .	2014	Asnjë punonjës i emëruar	100%	100%	
B	Programi i mbështetjes infrastrukturore për 61 bashkitë e reja	2015-2020	Nr. i projekteve infrastrukturore për bashkitë e reja	Numri i projekteve të financuara dhe të zbatuara nëpërmjet FZHR ka arritur në 32, (25 - ndërtim dhe rikonstruksion rrugësh, 2 ujësjellëse, 5 projekte të rikualifikimit urban dhe ndërtimit të qendrave të qyteteve)	2014	Asnjë projekt	20	32 projekte	
C	Aplikimi i shërbimeve të integruara administrative me teknologjine ICT për 61 bashkitë dhe njësitë administrative.	2015-2016	67 shërbime	Janë ngritur zyrat me një ndalesë në 14 bashki: (i) Shkodër, Lezhë, Durrës, Elbasan, Korçë, Vau Dejës, Mat ³⁶ , Klos, Sarandë, Berat dhe Fier. Është duke përfunduar ngritja në Bashkinë Roskovec dhe Patos. Në secilën prej bashkive janë zbatuar mbi 65 shërbime administrative si edhe është mundësuar perdorimi i sistemit edhe në NjA. ADISA ka hapur 3 zyra gjithashtu në Tiranë, Fier, Krujë dhe po vijon në Kavajë e Gjirokastrë. Numri i shërbimeve të identifikuar pas funksioneve të reja që i kanë kaluar pushtetit vendor është rritur nga 67 në 109 shërbime të digitalizuara.	2015	Asnjë shërbim	10 shërbime	34% e bashkive me OSSH 67 shërbime	
Ç	Inventarizimi dhe konsolidimi financiar i 61 bashkive	2015-2016	- VKM për aprovimin e inventarit të pronave në 61 bashki.	-VKM 510, datë 10 Qershor 2015 " Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial.	2015	VKM-ja nuk është miratuar dhe asnjë raport nuk është përfunduar	VKM e miratuar brenda 2015 si dhe deri në 2017	VKM 510 10 Qershor 2015	

³⁵ – VKM Nr. 235, datë. 18.3.2015. Për një shtesë në numrin e punonjësve dhe të fondeve buxhetore për Agjencinë e Zbatimit të Reformës Territoriale,

³⁶ Në bashkinë Mat OSSH aplikohet në 7 NjA (vetem në NjA Macukull nuk aplikohet nga mungesa e shërbimit të internetit); në bashkinë Klos OSSH aplikohet vetëm në Bashki dhe jo në NjA

			- Raportet Financiare reflektojnë dhe marrjen e detyrimeve financiare nga bashkimi i NjQV	Me projektin STAR janë hartuar 373 raporte financiare të NJQV dhe të konsoliduar në 61 bashkitë e reja. Raportet u vunë në dispozicion të Bashkive të reja dhe u diskutuan me BB dhe FMN për të adresuar zgjidhjen problemit të detyrimeve të prapambetura të mbartura në administratat e reja.			61 bashkitë me raporte të miratuara	100%
D	Përcaktimi gjeografik i kufijve administrative i 61 bashkive	2015-2016	Dokumenti ligjor që përcaktojnë kufijtë administrative të bashkive	Është hartuar draft VKM për përcaktimin e kufijve. Procesi është stopuar deri në saktësimin e kufijve për disa bashki që ka patur problematika	2015	Dokumenti ligjor nuk është miratuar	Brenda 2016 dokumenti ligjor i miratuar	
Objektivi Specifik I.2.2		Mbështetja institucionale dhe infrastrukturore për 12 qarqet dhe 61 bashkitë e reja pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015.						
Treguesi i Performancës		Treguesi i aplikimit të shërbimeve të integruara administrative nëpërmjet ICT			2014	0%	70%	95.6% në 34 % të bashkive
A	Hartimi i statuteve dhe rregulloreve model të 61 bashkive të reja	2015-2016	Modeli statuti i zhvilluar	Ligji i ri për qeverisjen vendore e ka shfuqizuar hartimin e statuti të bashkive.	2015	0% e 61 bashkive që kanë modelin e statutit dhe rregullores të miratuar	50%	16% (10 Bashki)
